

*Dr. Vehbetu Zuhejli
Profesor i fikhut Islam dhe usulit të tij
në Universitetin e Damaskut, Fakulteti i Sheriatit.*

**USULUL FIKHI ISLAM
- KUR'ANI DHE SUNETI -**

*“I jep urtësi atij që do.
Dhe atij që i jepet urtësi (dituri)
veç iu kanë dhënë të mira të shumta.”
(Kur’ani Fisnik)*

Autor:

Dr. Vehbetu Zuhejli

Titulli i origjinalit:

اصول الفقه الإسلامي

Titulli:

USUL UL FIKHI ISLAM – KUR'ANI DHE SUNETI

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Daut Shehu

Kaçanik

2016

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Autor:
Dr. Vehbetu Zuhejli

اصول الفقه الإسلامي

USULUL FIKHI ISLAM - KUR'ANI DHE SUNETI -

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2016

BURIMET E LIGJEVE TË SHERIATIT

Ndahet në dy pjesë:

Pjesa e parë:

Burimet bazore në të cilat janë pajtuar dijetarët.

Pjesa e dytë:

Burimet pasuese (degëzore) për të cilat nuk janë pajtuar dijetarët.

PJESA E PARË

Argumentet e sheriatit për të cilat janë pajtuar dijetarët

Burimet e ligjeve të sheriatit janë argumentet sheriatike prej të cilave nxirren ligjet e sheriatit.

Argument është shumësi i argumentit.

Gjuhësisht argument do të thotë: Udhëzues në diçka konkrete apo abstrakte.

Në terminologji: Është çështja me të cilën arrihet me shikim të shëndoshë në ligjin sheriativ praktik.

Argumentet janë dy llojesh:

1. Argumentet për të cilat janë pajtuar të gjithë dijetarët, e ato janë: **Kur’ani, suneti, ixhmai dhe Kijasi**, dhe

2. Argumentet për të cilat nuk janë pajtuar të gjithë dijetarët se janë argumente, e prej tyre më të njohura janë shtatë: **Istihسانی, Mesalihul murseli, istislahi, Istis-habi, urfi, drejtimi i sehabeve, ligji para nesh dhe Dherai**.

Pika e përkufizuar e argumenteve është se argumenti ose është prej shpalljes, ose jo prej shpalljes. Pastaj, shpallja ose është shpallje lexuese, ose shpallje jolexuese. Shpallja lexuese është Kur’ani, shpallja jolexuese është suneti.

Nëse argumenti nuk është prej shpalljes, atëherë shikohet, nëse është mendim i muxhtehidinëve të umetit, është ixhmai. Nëse është ligj që krahasohet me një çështje të ligjit tjetër, e që përputhen në shkakun, është kijasi. E, nëse nuk është kështu, është argumentimi (Istidlali), i cili është i ndarë në shumë lloje.

Katër argumentet e para janë argumente, për të cilat janë pajtuar dijetarët muslimanë se janë argumente, dhe është vaxhib të veprohet me ta. Po ashtu, janë pajtuar edhe në renditje të argumentimit, i cili është si vijon: **Kur’ani, Suneti, Ixhmai dhe Kijasi**. Argument për këtë është hadithi i Muadh bin Xhebelit r.a.. Kur i dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka

dërguar gjykatës të Islamit në Jemen dhe i thotë: ***O Muadh, nëse vjen te rasti të gjykos, si dhe me çka do të gjykos?***

Muadhi i thotë: ***“Do të gjykoj me librin e Allahut”.***

Pastaj, i thotë: ***“Po nëse nuk e gjen në librin e Allahut?”.***

Muadhi i thotë: ***Do të gjykoj me sunetin e të dërguarit të Allahut.***

Pastaj, i thotë: ***Po nëse nuk e gjen në sunetin e të Dërguarit të Allahut?***

Muadhi i thotë: ***Do të gjykoj me ixhtihadin tim, e nuk do ta lë çështjen e pazgjidhur (nuk do ta neglizhoj).***

I Dërguari i Allahut e vendos dorën në kraharorin e tij dhe i thotë: ***Falënderoj Allahun, për atë që pajtohet i Dërguari; i dërguari i Allahut është i pajtuar me atë çka është i kënaqur Allahu dhe i dërguari i Tij.***¹

Kur Ebu Bekri Sidikit i paraqiteshin palët e konfrontuara për gjykim në mes tyre, në rend të parë shikonte në librin e Allahut. Nëse e gjente aty, gjykonte sipas Kur'anit. Nëse nuk e gjente në librin e Allahut dhe e dinte se ka gjykuar për atë çështje i Dërguari i Allahut, ashtu gjykonte. Nëse nuk e dinte se ka gjykuar për atë çështje i dërguari i Allahut, i tubonte më të mirët e më të diturit dhe konsultoj me ta. Nëse pajtoheshin në mendime, ashtu urdhëronte dhe gjykonte. Kështu vepronte Omeri r.a. Kështu kanë vepruar edhe sehabet dhe këtë praktikë e kanë pranuar që të jetë projekti i muslimanëve.

Po ashtu, argumentet ose janë transmetuese, ose logjike.

Argumentet transmetuese janë: Kur'ani, suneti, ixhmai, urfi, ligji para nesh dhe mendimi i sehaveve.

Argumente logjike janë: Kijasi, Mesalihul murseli, Istihsan, Istis'hab dhe Dheraiu. Secili lloj e forcon tjetrin. Ixhtihadi patjetër duhet të përqendrohet në bazat e argumenteve logjike. Argumentet tekstuale patjetër duhen shikuar me logjikë, analizë dhe studim të shëndoshë.

Vërehet qartë se këto argumente:

-Ose janë baza të pavarura në sheriat, e ato janë: Kur'ani, suneti, Ixhmai dhe argumentet që kanë të bëjnë me ta, si Istihsan, urfi dhe mendimi i sehaveve,

-Ose nuk janë bazë e pavarur, siç është Kijasi.

Çështja se: argument bazë i pavarur në shariat nënkupton se nuk ka nevojë ligji të mbështetet në diçka tjetër, ndërsa Kijasi ka nevojë të vërtetohet si ligj me bazën e ardhur prej Kur'anit, sunetit dhe Ixhmait. Po ashtu, ka nevojë që të kuptohet shkaku i ligjit bazor. Nevoja e argumentit të ixhmait për mbështetje nuk nënkupton që të jetë i pavarur, sepse kjo është e kërkuar vetëm për ta ligjësuar si argument, e jo për të argumentuar. E kundërta me Kijasin, sepse të argumentuarit me Kijas ka nevojë për të përputhur bazën e ligjit me shkakun e tij.

Kapitulli i parë përbëhet prej katër temave:

Tema e parë: Kur'ani Fisnik apo libri i madhëruar

Tema e dytë: Suneti fisnik

Tema e tretë: Ixhmai

Tema e katërt: Kijasi

Tema e parë

Kur’ani fisnik apo libri fisnik

Libër gjuhësisht do të thotë çdo libër i shkruar, pastaj në sheriat e ka marrë kuptimin posaçërisht për librin e Allahut, e shkruar në mus-haf, e që ai libër është Kur’ani. Subevejhit në librin e tij thotë: Është përhapur në gjuhën arabe që libri (Kitabi) ka të bëjë me Kur’anin.

Kur’ani në gjuhën arabe është infinitiv që ka kuptimin “*Lexim*”. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“E kur ta lexojmë atë ty (Kuranin),ti përcille me të dëgjuar leximin e tij”.

Pastaj, në literaturë dhe në të folur është përhapur kuptimi se është fjalë e Allahut, e cila lexohet prej gjuhës së robërve. Në këtë kuptim është më i njohur, kështu që Kur’ani është interpretim i tij (Kitabit)

Në këtë temë do të sqaroj si vijon:

Definicioni i Kur’anit;

Specifikat e Kur’anit;

Argumentimi i Kur’anit;

Mrekullia e Kur’anit;

Dispozitat e Kur’anit;

Argumentimi me ligje;

Metodologjia sqaruese; dhe

Disa rregulla bazore të përgjithshme që kanë të bëjnë me Kur’anin.

Definicioni i Kur'anit

Ndonjëherë thuhet: S'ka nevojë të jepet definicioni i Kur'anit, sepse çdo njeri e di saktësisht çka është Kur'ani, i përbërë prej ajeteve dhe sureve që janë të njohura. Por, definicioni është për ta treguar tërësinë e çështjes dhe vërtetësinë e saj, si f.v. kur ti e definon njeriun se është trup i lëvizshëm, i ndjeshëm me dëshirë dhe folës.

Përgjigja për këtë është se: Definicioni i Kur'anit shikohet nga kuptimi i përgjithshëm, sepse Usulijinët e definojnë Kur'anin për të sqaruar çka lejohet dhe çka nuk lejohet në namaz, çka është argument në nxjerrjen e ligjeve të sheriatit e çka jo, në çka mund të kalojë në pabesim një mohues, e në çka jo. Qëllimi është definicioni i Kur'anit, i cili është argument në fikh.²

Shkurt: definicioni i Kur'anit është nga aspekti i argumentit si ligj i sheriatit. Ai ose definohet si kuptim i tërësishëm që të përfshijë Kur'anin, që të përfshijë të gjitha specifikat, që janë posaçërisht për të. Ai është zbritje te i dërguari i Allahut, i shkruar në mus'haf, i transmetuar tek ne në mënyrë të përpiktë dhe në mënyrë absolute.

Definicioni: **“Kur'ani është fjalë e Allahut, i zbritur te Pejgamberi s.a.v.s. në gjuhën arabe, i cili sfidon edhe me surën më të shkurtër, i shkruar në mus'haf, i transmetuar përpikërisht, i konsideruar ibadet leximi i tij, duke filluar me suretull Fatiha dhe i përfunduar me suretull Nas.**³

Disa e kanë definuar se Kur'ani është fjalë arabe e zbritur për të menduar dhe analizuar, i cili është i përpiktë. Pjesa e këtij definicioni **“për të menduar dhe analizuar”** është vetëm sqarim i definicionit, e assesi nuk është thënë që patjetër të ekzistojë në definicion.

Specifikat e Kur'anit: Nga definicioni kuptohet se specifikat e Kur'anit dhe veçoritë e tij bëjnë dokumentojnë se çdo gjë çka është fjalë e Allahut nuk është në Kur'an, po ashtu çka nuk është fjalë arabe prej librave qiellor nuk është Kur'an dhe ajo çka nuk ka zbritur në gjuhën

arabe prej librave tjera të zbritura nuk është Kuran. Po ashtu, nuk është Kur'an ajo çka nuk është mutevatir, as shadh, e as hadithet Kudësij nuk janë Kur'an, dhe çka nuk ka zbritur të jetë mrekulli, si të gjitha librat qiellore dhe suneti në përgjithësi, nuk janë Kuran.

E para: “Është fjalë e Allahut të Lartmadhëruar.”, argument për këtë është mrekullia e tij; mrekullia e tij është niveli i tij oratorik dhe stilistik që ia tejkalon aftësive njerëzore. Për këtë arsye, kur i ka sfiduar arabët, ata janë ndier të paaftë përballë (belagës) stilistikës dhe oratorisë së Kur'anit. Së shpejti, kur do të flasë për mrekullitë e Kur'anit, do të flasë për këtë. Pasi që Kur'ani është prej Allahut, konsiderohet argument i domosdoshëm dhe çdo ligj që buron prej tij është obligativ të veprohet. Çdo njeri duhet të pasojë ligjet e tij. Kur'ani dallohet prej haditheve të Pejgamberi s.a.v.s., pa marrë parasysh se a janë ato hadithe kudësij apo hadithe pejgamberike, sepse **“kuptimi”** i haditheve është prej Allahut, ndërsa fjalët-prej Pejgamberit s.a.v.s. Mirëpo, Pejgamberi s.a.v.s. ndonjëherë është urdhëruar që hadithin ta thotë drejtpërsëdrejti (Ligjërata e drejtë) prej Allahut, që quhet hadith kudësij, e ndonjëherë nuk është i urdhëruar ta thotë hadithin në ligjëratën e drejtë, apo se është drejtpërsëdrejti prej Allahut të Lartmadhëruar, e që quhet hadith i Pejgamberit s.a.v.s..

E dyta: “I tërë Kur'ani është në gjuhën arabe.” dhe nuk ka asnjë fjalë të gjuhës joarabe.⁴ Imam Shafiju, sa i përket atyre që thonë se në Kuran ka edhe fjalë joarabe, në fq. 41 të **“Risales”**, në mes tjerash, thotë: Është thënie shkencore se: Të heshturit prej asaj çka është thënë ka përparësi heshtja dhe më e mirë se sa të thuhet vetëm ajo pjesë që është thënë. Nëse do Allahu.

Disa kanë thënë: në Kur'an, përpos fjalëve të gjuhës arabe, ka edhe fjalë joarabe. Ndërsa, Kur'ani e thotë se në librin e Allahut nuk ka asgjë tjetër pos gjuhës arabe. Pastaj, iu kundërvihet me argumente atyre se: Mosdija e disa arabëve për disa fjalë të Kur'anit, se në bazë të tyre ka fjalë të huaja, nuk do të thotë se Kur'ani ka fjalë të huaja, sepse është e mundur që disa gjuhë të huaja kanë huazuar disa fjalë arabe dhe ato fjalë janë përhapur në ato gjuhë dhe janë bërë fjalë të atyre gjuhëve, e pastaj, disa fjalë të Kur'anit (ato fjalë), që janë të pakta, janë në përputhshmëri

me fjalët e Kur'anit. Por, është e mundur që disa fjalë të huaja kanë hyrë në përdorim të gjuhës arabe, e ato fjalë janë bërë arabe më, kështu që ato formën e kanë arabe, ndërsa mënyrën të huaj, edhe pse esenca është fjalë e huaj. Pastaj, Shafiju i ka paraqitur disa ajete Kur'anore, si p.sh: Fjala e Zotit të Lartmadhëruar: ***“Dhe nuk ka dyshim se ai (Kur’ani) është zbritje prej Zotit të botëve”, “E ka zbritur atë shpirti (Xhibrili) besnik, në zemrën tënde që të jetë tërheqëvërejtës në gjuhën arabe të pastër (të kulluar)”***.

Dhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar: ***“Kur’ani në gjuhën arabe, ku në të nuk ka kurrëfarë shtrembërimi, me qëllim që të bëhen të devotshëm”***.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: ***“Ne veç e dimë me siguri për atë çka thonë”***.

“Thonë: Vërtet, atë (Muhamedin) e mëson një njeri. Gjuhën (e Kur’anit), të cilën e kundërshtojnë, a mos është e huaj. Kurse ky (Kur’an) është në gjuhën arabe të pastër”

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***“Po ta kishim bërë atë (Kur’anin) Kur’anin në gjuhë të huaj, do të thoshin: Po pse ajetet janë të pasqaruara. Pse a mos është e huaj, kur dihet se është në gjuhën arabe”***.

Pastaj, dihet se libri i çdo peygamberi është në gjuhën e popullit të tij. Shafiju thotë: Çdo musliman duhet ta mësojë gjuhën arabe sa të ketë mundësi, sa që ta thotë shahadetin në gjuhën arabe ***“Eshhedu en LaiLahe il-allah ve eshhedu ene Muhameden abduhu ve resuluhu”***, që të lexojë librin e Allahut, të bëjë duatë farze, të thotë Tekbirin, Tesbihun, Etehijatin etj etj. Të mësuarit e gjuhës arabe ka domethënie shoqërore dhe politike, sepse bashkon ndjenjat e umetit islam, forcon lidhjet mes tyre, e ruan islamin dhe vlerat e tij, e dallon personalitetin islam ndaj të tjerëve dhe e forcon islamin në përgjithësi.

Përpos kësaj, ndryshimi i një sure apo ajeti me një fjalë sinonime të Kur’anit, nuk konsiderohet Kur’an, sado që komentuesi apo interpretuesi është i përpiktë në sqarimin e asaj fjale, sepse Kur’ani në

gjuhën arabe është posaçërisht Kur'an, në të cilën gjuhë e ka zbritur Allahu i Lartmadhëruar.

Përkthimi i Kur'anit, sado që ai përkthim të jetë i saktë, nuk llogaritet Kur'an. Nuk lejohet të bazohet që prej atij përkthimi të nxirren ligje të sheriatit, sepse të kuptuarit e qëllimit të ajeteve mund të jetë i gabuar, e përkthimi në gjuhë tjetër, po ashtu, mund të jetë i gabuar. Për këtë arsye, nuk duhet bazuar në përkthim, përderisa janë të mundur dy variante.

Namazi me përkthim nuk pranohet, sepse Kur'ani është emër i konstruktit dhe i kuptimit. Konstrukti është fjalë, e cila nënkupton Kur'anin në mus'haf. Kuptimi është fjalë, e cila tregon domethënien e vërtetë vetë fjala. Nuk mund të kuptohen ligjet e ligjvënësit në Kur'an pa e ditur kuptimin e konstruktit.

Ndërsa, sa i përket asaj se Ebu Hanifja r.a. e ka lejuar leximin e Kur'anit në namaz në gjuhën persiane,⁵ nuk kuptohet prej këtij mendimi se lejohet leximi vetëm me kuptim, sepse për këtë janë pajtuar shumica absolute e dijetarëve.

Por, Ebu Hanife e ka lejuar vetëm si formë lehtësimi. Kështu e ka sqaruar Bezdeviju, autor i librit **“Keshful Esrarë”**, sepse ndërtimi i konstruktit është për të zgjeruar, e kjo në këtë rast nuk është për qëllim, posaçërisht në namaz, ku është në pyetje lutja. Sa i përket leximit në namaz, kjo është bërë vetëm për lehtësim. Këtë e thotë Zoti i Lartmadhëruar **“Dhe lexoni atë çka është më e lehta në Kur'an”**.

Përpos kësaj, autori i librit **“Sharihul Menar”** dhe autori Sadru Sheria në librin e tij **“Tevdijh”** dhe autori Kemal bin Hemami, kanë thënë: E vërteta është se ka diferencë nga ky mendim. Këtë e tregon edhe Nuh bin Ebi Mejrem, sepse me këtë kuptohet njëra prej dy kuptimeve:

- Ose zhvleftësimi i definicionit të Kur'anit, sepse Kur'ani në gjuhën persiane nuk është i shkruar në mus-haf,
- Ose lejimin e namazit pa lexim të Kur'anit, sepse Kur'ani është emër konstruktiv i kuptimit.⁷

E treta: Kur'ani është bartur në mënyrë të përpiktë nga të gjithë, pra në formë të bartjes, çka tregon saktësinë dhe vërtetësinë e transmetimit në formë të prerë.⁸ Kjo është çështje absolute e Kur'anit

edhe në formën e të shkruarit, edhe në formën e të lexuarit, gjatë gjithë kohërave, prej fillimit të zbritjes së shpalljes nga shpirti (Xhibrili) besnik tek Pejgamberi s.a.v.s. e deri në ditët e sotme. Shkruesit e shpalljes shkruanin Kur'anin, kur i zbriste Pejgamberit s.a.v.s., pastaj, ajo çka zbriste, sehabet e mësonin përmendësh, me dëshirë që të përfitonin prej tij, që t'u përmbaheshin urdhrave dhe ligjeve të tij. Këto dy forma (të shkruarit dhe të mësuarit përmendësh) kanë vazhduar gjatë gjithë kohërave dhe gjeneratave, e deri tani, ku të parët ia përcjellin brezave pas tyre në mënyrë të sigurt dhe besnikërisht, sa që është e pamundur që të gjitha gjeneratat e të gjitha vendeve të bashkohen për rrenë, shtim apo mangësi. Historia është dëshmitari më i mirë. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: **“Vërtet, Ne e kemi zbritur Kur'anin dhe Ne e ruajmë atë”**.

Të përcjellurit e Kur'anin me përpikmëri nga të gjithë (tevatur) është veçori e këtij libri fisnik, nga të gjithë librat tjerë qiellor, pa pasur kurrfarë ndryshimi dhe kurrfarë shtrembërimi. E jo, siç na e kanë vërtetuar historianët për Tevratin dhe Inxhilin, se përmbledhja e këtyre librave është bërë pas një kohe shumë të gjatë prej vdekjes së Musa a.s. dhe Isa a.s., sa që ajo kohë sillet rreth një apo dy shekujve.

Duke pasur parasysh se Kur'ani është fuqizuar në mënyrë të prerë, të përpiktë dhe të saktë, atëherë edhe tekstet (ligjet) e tij janë të përpikta dhe të sakta, pa pasur kundërshtim prej asnjë dijetari.

Nga kjo specifike rezulton se ajo çka nuk është mutevatir (i përcjellur përpikërisht nga të gjithë), si f.v. Kiraat Shadhe (leximet e vetmuara) dhe hadithi Kudësij, nuk konsiderohet Kur'an.⁹ Nga pjesa e definicionit **“mutevatir”** Hanefijtë e kanë hequr edhe leximin e vetmuar, siç është leximi i Ubej bin Keabit **“Ideti i tyre edhe disa ditë tjera të njëpasnjëshme”**. Po ashtu, e kanë hequr edhe pjesën me të cilën është veçuar Ibni Mesudi në mus-hafin e tij, meshurë siç është te leximi i ajetit të dënimit për vjedhje **“Dhe prejuani duart e djathta të tyre”**.

Në këtë temë do të përqendrohemi në dy çështje:

1. Dispozita e leximeve të vetmuara (shadhë);
2. Bismilahi është pjesë e Kur'anit?

Leximet e vetmuara

Për atë çka është përcjell deri tek ne në mënyrë të vetmuar, si Mus'hafi i Ibni Mesudit etj, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme: a është Kur'an apo jo?

Leximi i vetmuar është leximi, i cili nuk është përhapur në të gjitha rajonet, në formën mutevatir.¹⁰ Është leximi, i cili rrugën zinxhirore e ka të drejtë, mirëpo nuk përmban më vete konstruktin e mus'hafit në të shkruar, edhe pse është në harmoni me gjuhën arabe dhe kuptimet e gjuhës arabe, si f.v. leximi (Kiraeti) i Ibni Mesudit në ajetin e kompensimit të përbetimit: **“Dhe kush nuk ka (mundësi), le të agjërojë tri ditë - të njëpasnjëshme”**. Shtesa e ajetit **“të njëpasnjëshme”** nuk është **“Mutevatir”**, e për këtë arsye edhe nuk është Kur'an.¹¹

Shembull tjetër: Ajo çka është në disa kiraete në furnizimin e nënave: **“Dhe për trashëguesin - prej farefisit të ndaluar”**. Në këtë rast shtesa **“prej farefisit të ndaluar”** nuk është Mutevatir.

Ibn Ethirë el Xhezariju thotë: Leximet e vetmuara (**“Kiraat Shadhe”**) janë lexime, të cilat nuk e kanë zingjirin transmetues të plotë. Shembull: ajeti **“Dhe sot do ta mënjanojnë trupin tënd, që të jetë argument për (gjeneratat) pas teje”**. Ndërsa, leximi i ajetit sipas Hafsës është **“Do ta shpëtojmë (trupin tënd nga shkatërrimi)”**.

Dijetarët e kiraeteve janë pajtuar se shtatë kiraetet janë mutevatir me koncenzusin (ixhmain) e të gjithë muslimanëve.¹² Ato kiraete janë:

1. Kiraeti i Ebi Amrit,
2. Kiraeti Nafijut,
3. Kiraeti Asimit,
4. Kiraeti i Hamzës,
5. Kiraeti i Kisaijut,
6. Kiraeti i Ibni Kethirit, dhe
7. Kiraeti i Ibni Amirit.

Ndërsa, plus tre kiraete, pas këtyre shtatë kiraeteve, janë:

- 1.Kiraeti i Jakubit,
- 2.Kiraeti i bi Xhaëferit dhe
3. Kiraeti i Halefit.

Për këto tre kiraete disa kanë thënë se janë Kiraete mutevatir, ^{13e} disa kanë thënë se janë Kiraete meshhurë.

Përpos këtyre dhjetë kiraeteve, kiraetet tjera janë të vetmuara dhe për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët.

Dispozita e kiraeteve të vetmuara

Leximi i vetmuar nuk është Kur'an.¹⁴ Ky është mendimi unanim i të gjithë dijetarëve. Por, parashtrohet pyetja: A lejohet të argumentohet me ato kiraete?.

Për këtë dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme:

Hanefijtë dhe Hanbelijtë thonë: Me leximet e vetmuara lejohet të argumentohet, por me kusht që argumentimi mos të jetë i prerë e as i sigurt, sepse për të qenë argument i sigurt patjetër duhet të jetë dëgjuar prej Pejgamberit s.a.v.s. dhe çdo gjë çka është e dëgjuar prej Pejgamberit s.a.v.s., është argument. Është argument dëgjimi, sepse transmetuesi është i drejtë. Drejtësia është cilësi që tregon se ai nuk e ka thënë prej vetvetes, sepse po ta kishte thënë prej vetvetes, nuk kishte qenë e shkruar në mus'haf. E, kjo do të thotë se ky lexim është dëgjuar prej Pejgamberit s.a.v.s., e të dëgjuarit prej Pejgamberit s.a.v.s. është sunet. Ndërsa, të vepruarit me sunet është obligative.¹⁵

Malikijtë dhe Shafijtë thonë: Leximet e vetmuara nuk janë argument. Argumentohen me atë se nuk është Kur'an, pra nuk është mutevatir, por edhe sunet nuk është, sepse ai lexim është transmetuar se është Kur'an, e pasi që nuk është transmetuar se është sunet, nuk argumentohet me të.¹⁶

Gazaliu i është kundërpërgjigjur medhhebit Hanefij në këtë mënyrë: Nuk është Hadith i vetmuar, sepse hadithi i vetmuar nuk është argument se nuk pranohet. Ndërsa, të bëhet se është Kur'an, është gabim i sigurt, sepse do të kishte qenë e detyruar për Pejgamberin s.a.v.s. t'u

tregonte disa sehaveve që të jetë argument për ta. E, atëherë nuk kishte qenë e lejuar që të heshtë asnjëri prej tyre, pasi që nuk është Kur'an. Atëherë, është e mundur që të jetë mendim i sehabës, ose që të jetë lajm i Pejgamberit s.a.v.s.. Pasi që është e dyshimtë se a është haber apo jo, atëherë kjo na tregon se nuk lejohet të veprohet (argumentohet) me të, sepse lejohet të veprohet (argumentohet) me atë çka transmetuesi tregon se ka dëgjuar nga Pejgamberi s.a.v.s. Këtë mendim e ka përkrahur edhe Amediju, kur thotë: Mendimi më i pranuar dhe më i drejtë është mendimi i Shafijut, i cili mendon se nuk është obligative që te kompensimi i përbetimit të agjërohet rreshtazi.

Autori i librit **“Muslimu Thubut”** dhe Shevkani në librin **“Irshadul Fuhul”** thonë: Çka është transmetim i vetmuar, absolutisht nuk është Kur'an, sepse Kur'ani është ai çka i plotëson kërkesat e transmetimit si fjalë e Allahut të Lartmadhëruar, çka i plotëson të gjitha kushtet e ligjeve të shariatit dhe si mrekulli. Çka i plotëson këto kërkesa, është Kur'an, e çka nuk i plotëson, nuk është Kur'an.

“Bismilahi” a është ajet Kur'anor?

Për atë se **“Bismilahi”** a është ajet i Kur'anit fisnik, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme.

Pos kësaj, nëse është ajet, pra se a është ajet i çdo sureje, prapë kanë dhënë mendime të ndryshme: se a është ajet i pavarur i çdo sureje, i cili ka zbritur për t'i ndarë suret në mes vete apo jo?!

Muslimanët janë pajtuar unanimisht se **“Bismilahi”** është ajet në brendi të “suretul Neml”, por kanë dhënë mendime të ndryshme për **“Bismilahin”** në fillim të sureve:

Shafijtë dhe ajo çka është më prioritarja në medhhebin e tyre thonë: Është ajet i çdo sureje edhe i suretul fatiha, edhe i sureve të tjera, përpos në suretul Beraetun.¹⁷ Sujutiu i ka sjellë pesëmbëdhjetë hadithe, të cilat tregojnë se **Bismilahi** është për të filluar suret dhe atë në mënyrë të përgjithshme.¹⁸

Malikijtë thonë: Nuk është ajet as i suretul Fatihas, e as i sureve të tjera.¹⁹

Hanefijtë, sipas mendimit më të drejtë të tyre, thonë: Është ajet Kur'anor, por nuk është ajet i suretul Fatihas dhe as i sureve të tjera, por është ajet i cili ka zbritur për t'i ndarë suret në mes vete.²⁰

Hanefijtë në medhhebin e tyre argumentohen se: Ixhmai ka rënë dakord se çka është mes dy kopertinave të Mus'hafit, është fjalë e Allahut dhe është shkruar në Kur'an me urdhrin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe ashtu na është transmetuar brenda dy kopertinave të mus'hafit. Paralelisht me këtë, sehabet e mësonin vazhdimisht përmendësh, sa që ata nuk lejonin që të shkruheshin edhe emrat e Kur'anit në mus'haf, as kornizat, as pikat, me qëllim që Kur'ani të mos përzihet me asgjë tjetër. Pasi që nuk është ajet as i suretul Fatihas e as sureve të tjera, por i ka plotësuar kushtet që obligon të jetë ajet i çdo sure, është zbritur për t'i ndarë suret në mes vete. E, kjo tregon se nuk është pjesë e asnjë sureje. Në medhhebin e tyre është bazë që për të qenë ajet Kur'anor duhet të lexohet, të vendoset në vendin e merituar, të jetë i transmetuar, duhet t'i plotësojë kushtet e parapara. Mendimi i tyre përputhet me mendimin e Ibni Abasit r.a., i cili ka thënë: Pejgamberi s.a.v.s. nuk e dinte përfundimin e sures dhe fillimin e sures tjetër, derisa Xhibrili nuk i zbriste ajetin **“Bismilahi-Rrahim”** në fillim të çdo sureje. E, kjo e vërteton se është për ndarjen e sureve në mes vete.

Argumentet e Malikijve janë si vijon:

Transmeton Muslimi nga Ajshja r.a. se ka thënë: Pejgamberi s.a.v.s. e fillonte namazin me tekbir dhe me fillimin e leximit **“Elahamdulilahi Rabil Aleminë”**.

Në dy sahihët është regjistruar nga Enes bin Maliku se ka thënë: Jam falur pas Pejgamberit s.a.v.s., pas Ebu Bekrit dhe Uthmanit dhe e fillonte namazin me **“Elhamdulilahi Rabil Aleminë”**.

Në sahihun e Muslimit “Nuk e përmendin **“Bismilahi Rrrahmani Rrahim”** në fillim, as në përfundim të leximit. Ngjashëm me këto është

edhe në koleksionet e haditheveve (sunen) nga Abdullah bin Mugfeli r.a.²¹

Medhhebin e tyre e forcon dhe e përkrahin banorët e Medines. Ata janë më të diturit se sa të tjerët, për shkak se ka qenë rreth i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Shafijët janë argumentuar me sa vijon:

- Ajeti ka zbritur me fillimin e çdo sureje.

- **Bismilahi** është shkruar në Kur'an në fillim të çdo sureje me urdhrin e Pejgamberi s.a.v.s. dhe kjo është praktikuar nga të gjithë dhe se asnjëri prej sehaveve nuk e ka kundërshtuar shkrimin e këtij ajeti, kur dihet se ata kanë qenë tepër të kujdesshëm që të mos shkruhet në Kur'an ajo çka nuk është Kur'an.

Thënia e Shafijut është bazuar në medhhebin e tij, pasi që ajeti i lexuar i ka plotësuar kushtet e ajeteve të tjera, edhe pse është posaçërisht për një ajet.

Këtë mendim e forcon edhe në ether (ajo çka është gjurmuar). Është transmetuar nga Ibni Abasi se thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Dhe Ne ty të kemi dhënë shtatë të përsëriturat”**, ka për qëllim suretul Fatiha.

E, kur është pyetur: Po ku është ajeti i shtatë?

Është përgjigjur: Ajeti i shtatë është **“Bismilahi Rrahmani Rrahim”**.

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Kur të lexoni suretul Fatihan, mos harroni pa e lexuar edhe ajetin Bismilahi Rrahmanirr Rrahim”**, sepse ky ajet është ajet i kësaj sureje.²²

Sa i përket sureve të tjera, na është sjellë sigurt nga të gjithë se është vendosur në fillim të çdo sureje, si në fillim të suretul Fatihas, ashtu edhe në të gjitha suret tjera. Ibn Mubareki thotë: Kush nuk e lexon **“Bismilahin”**, ai nuk i ka lexuar njëqind e trembëdhjetë ajete.

Në fund të këtyre mendimeve të ndryshme po përmend atë që ka thënë Shevkaniju në librin **“Irshad Fuhulë”**. Sa i përket kësaj teme, një grup i usulijinëve e kanë përmendur mospajtimin; po ashtu ka ndodhur mospajtimi edhe në mes të Kurrave (lexuesve të Kur'anit), e po ashtu ka ndodhur mospajtim në mes të dijetarëve se: Bismilahi a është ajet i çdo

sureje apo është ajet i vetëm suretul Fatihas, apo është ajet i pavarur, i cili ka zbritur për ndarjen në mes të sureve, apo nuk është ajet dhe nuk është pjesë e Kur'anit; në lidhje me këtë kanë bërë studime të thella.

Disa dijetarë kanë shkuar aq larg sa që këtë çështje e kanë bërë prej çështjeve të besimit dhe prej çështjeve bazike të fesë.

E vërteta është se **“Bismilahi”** është ajet i çdo sureje, pasi që është shkruar në mus-haf. Kjo është shtylla e parë dhe kryesore që tregon Kur'anin për Kur'anin.

Pastaj, ixhmai që e ka pranuar të shkruhet në Kur'an në fillim të çdo sureje dhe këtë nuk e ka kundërshtuar askush, kështu që kemi kaluar edhe shtyllën e dytë, pra të përcjellurit nëpërmjet ixhmait nëpër gjenerata.

Ndërsa, shtylla e tretë është përputhshmëria me gjuhën arabe dhe me kuptimin e gjuhës arabe. E, kjo është tepër e qartë në Kur'an.²³

Ibn Haxhibi thotë: Fortësia e ngjashmërisë në dy anët te **“Bismilahi Rrahmani Rrahim”** është pengesë për të mos lejuar mohimin nga asnjëra anë.²⁴

Ibni Ethiri, pasi tregon argumentet e medhhebeve, thotë: Këto janë argumentet e dijetarëve, Zoti i mëshiroftë, dhe që të gjithë janë pajtuar se lejohet namazi, edhe nëse lexohet haptazi **“Bismilahi”**, por edhe nëse lexohet fshehtazi, prapë Falënderojmë Allahun.²⁵

Argumentimi i Kur'anit fisnik

Të gjithë Dijetarët janë pajtuar se Kur'anin është argument, me të cilin është e patjetërsueshme (vaxhib) të veprohet me të dhe nuk lejohet të kalohet në argumente tjera, përpos në raste kur duhet të gjykohet duke hulumtuar nëpërmjet tij.

Argument se Kur'anin është argument për njerëzit dhe duhet të veprohet me ligjet e tij, është se Kur'anin është prej Allahut, e argument se është prej Allahut, është mrekullia e tij.

Mrekullia e Kur'anit Fisnik

Mrekulli gjuhësisht do të thotë: **Paaftësia e atij i cili dëshiron të sjell diçka që ka sjell tjetri**. Thuhet: U tregua i paaftë ai njeri ndaj vëllait të tij kur tregon paaftësi për të vërtetuar diçka.

Mrekullia në Kur'an është: Qëllimi (insistimi) për të paraqitur vërtetësinë e Pejgamberit për shpalljen me veprime që janë jashtë natyrshmërisë njerëzore.²⁶

E para: Sfidimi, pra të kërkuarit prej të tjerëve për të bërë një gjë të tillë.

E dyta: Ai, i cili sfidohet, të ketë mundësi të ballafaqohet dhe të jetë prezent.

E treta: Që të mos ketë pengesë, e cila e pengon të sfiduarit për t'u ballafaquar me sdifuesin.

Kur'ani i ka plotësuar këto tri kushte. Pejgamberi s.a.v.s. i ka sfiduar njerëzit me Kur'an. Arabët, të cilët janë sfiduar, kanë qenë prezent dhe nuk kanë pasur kurrfarë pengese për t'u ballafaquar, mirëpo prapëseprapë nuk kanë mundur të përpilojnë një Kur'an të tillë.

Sa i përket sfidimit: Në shumë ajete Zoti i Lartmadhëruar i ka sfiduar. Prej tyre po përmendim këto ajete:

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Nëse ju jeni në dyshim në atë çka i kemi zbritur robit Tonë (Muhamedit a.s), atëherë sillni një sure të ngjashme me të (Kur'anin) dhe thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj në vend të Allahut, nëse jeni të sigurtë”.(el-Bekare,23)

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Nëse nuk mundeni, dhe padyshim se nuk do të mundeni, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët dhe që është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit”.(el-Bekare24)

Ua ka bërë me dije në mënyrë të prerë njerëzve se nuk munden, sepse Kurani është fjalë e Allahut, dhe e askujt tjetër, dhe asnjë arab në gjuhën arabe kurrë nuk mund të sjellë një Kur'an të tillë.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Edhe po thonë është trillim. Thuaj: më sillni dhjetë sure të ngjashme të trilluara dhe thirrni atë që keni mundësi, përpos Allahut, nëse jeni të sinqertë”.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Thuaj: po qe se mblidhen njerëzit dhe xhinët për të sjellë diçka të ngjashme me Kur'anin, nuk mund të sjellin një Kur'an të ngjashëm, edhe po qe se i ndihmojnë njëri-tjetrit (për të sjellë një Kur'an të tillë)”.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Thuaj, pa më sillni një libër prej Allahut, i cili do të jetë më udhëzues, nëse jeni të sinqertë”.

Të gjitha këto ajete fisnike sfidojnë arabët që të sjellin një Kur'an të ngjashëm. Ata e kanë dëgjuar sfidimin, por asnjëherë nuk kanë mundur dhe nuk do të jenë në gjendje të sjellin një Kur'an të tillë, edhe nëse të gjithë së bashku tubohen dhe i ndihmojnë njëri-tjetrit për të sjellë një Kur'an të tillë.

Sa i përket kushtit të dytë, që të bëhet ballafaqimi i drejtpërdrejtë, Pejgamberi s.a.v.s. u ka treguar arabëve se është Pejgamber i Allahut dhe ka ardhur me fenë, e cila do ta zëvendësojë fenë e tyre dhe do t'i largojë traditat e tyre, për t'i mënjeluar iluzionet e tyre, për t'i zhdukur idhujt, për t'i mënjeluar nga adhurimi i tyre. Argument i fuqishëm është libri i

Allahut. Arabët kanë qenë prioritar për të mbrojtur atë që ata kanë besuar dhe se për ta mposhtur atë Pejgamberi s.a.v.s. e ka sjellë prej Allahut, pa e përdorur shpatën, siç ka dashur që në fund edhe ta përdorin. Në fund e pranuan, edhe u dorëzuan dhe pranuan madhështinë e Kur'anit të përulur; as nuk dolën në duel dhe as nuk kundërshtuan.

Sa i përket kushtit të tretë: Nuk ka pasur ndonjë pengesë midis të sfiduesit dhe të sfiduarit, është se Kur'ani ka zbritur në gjuhën e pastër arabe, me shkronja arabe, me frazat dhe me metodologjinë arabe, me kuptime të gjuhës arabe. Ata kanë qenë të zotët e retorikës dhe stilistikës arabe, të oratorisë dhe të ligjërimit, poetë dhe gjuhëtarë. Në këto drejtime ata kanë qenë të njohur nëpër manifestime, teatro e garime. Përpos kësaj, në mesin e tyre ka pasur magjistarë të njohur e prozatorë. Kur'ani nuk ka sfiduar vetëm një grup të caktuar, por të gjithë. Kur'ani nuk ka zbritur i tëri përnjëherë, por ka zbritur pjesë-pjesë, në një periudhë prej njëzet e tri vjetësh, që të sfiduarit ta kenë më lehtë të paraqiten me idetë e tyre, që t'u jepet rasti i volitshëm dhe të kenë mundësi në garim. Por, ata nuk kanë mundur të sjellin asnjë sure, bile asnjë ajet të ngjashëm me Kur'anin fisnik.

Ky koment e mposht drejtimin Bakilanik, i cili thotë se arabët nuk kanë sjellë një Kur'an të tillë, sepse Allahu nuk do t'i lejonte për të bërë një gjë të tillë, për shkak të armiqësisë dhe zilisë së tyre.

Format e mrekullisë së Kur'anit

Tema e mrekullisë së Kur'anit është e pakufishme dhe njeriu nuk mund ta përkufizojë. Sado që ditët kalojnë, sado që periodat kohore ndryshojnë, prapëseprapë paraqiten argumente të reja në horizont që dëshmojnë për mrekullinë e Kur'anit, sepse fjala e Allahut është e pakufishme, sikurse është e pakufishme Madhështia e tij, me të gjitha cilësitë dhe me diturinë e Tij. Dituria e Allahut përfshin qiejt dhe tokën.

Usuliji flet për mrekullinë në masë sa i nevojitet qëllimit të tij. Për këtë arsye, unë do t'i përmend vetëm disa shkëndija të mrekullisë.

Të gjithë dijetarët janë pajtuar se arabët kanë qenë të paaftë në të gjitha fushat stilistike, kuptimore dhe oratorike të sjellin një Kur'an. Mendjet nuk kanë arritur dhe nuk do të arrijnë të mrekullia Kur'anore. Sa më shumë që njerëzit studiojnë Kur'anin, aq më e fuqishme paraqitet mrekullia e Kur'anit. Sa më shumë që shkenca zbulon të fshehtat e kozmosit, fshehtësitë e krijesave, paraqiten forma të reja të mrekullisë, dhe se Kur'ani është prej Allahut të vetmit, Mposhtësit, dhe se Kur'ani është mrekullia e përjetshme e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s..

Tani do të përmendim disa prej formave të mrekullisë së Kur'anit.²⁷

1. Mrekullia e të shprehurit, kuptimit, gjithëpërfshirja e ligjeve dhe qëllimet e tij.

Kur'ani përbëhet prej më shumë se 6000 ajeteve (6236) me tematikë të ndryshme të besimit, ligjësimit dhe moralit; përmban shumë tema të gjithësisë, sociologjisë dhe të ekzistencës dhe nuk mund të shihet se një ajet është në kundërshtim me ndonjë ajet tjetër ose me ligj, që është në kundërshtim me ndonjë ligj tjetër, edhe pse Kur'ani ka zbritur në një periudhë prej njëzet e tri vjetësh.

Po ashtu, nuk mund të hasen disharmoni dhe kundërshtime në mes të shprehjeve stilistike dhe oratorike. Mirëpo, çdo gjë në të është në harmoni dhe në përputhshmëri. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“A nuk po e logjikojnë Kur'anin. Po të kishte qenë jo prej Allahut, do të gjenin disharmoni dhe kundërshtime të shumta”**

Oratorët arabë kur e merrnin një tematikë, për atë tematikë e thurnin një varg poetik, ose dy vargje, ose shumë vargje. Ata thoshin: njeriu matet kur të hipë në peshojë guximi në rast frike, kënga kur të këndohet, kënaqësia kur të përjetohet. Këta kanë qenë oratorët më të shquar. Oratoria e tyre prapëseprapë ka qenë e kufizuar, siç është vërejtur në paraqitjet e tyre të njohura. Idetë e tyre kanë qenë të ngushta, nuk kanë thurur vargje për botën tjetër, e as për pastrimin e shpirtit dhe ngritjen e moralit, por thurnin vargje për përshkrimin e gjendjes faktike, krenaritë dhe tema të përditshmërisë.

Sa i përket Kur'anit, tematikat e tij janë gjithëpërfshirëse, dispozitat e tij janë të plota, sqarimet e mjaftueshme për çdo qëllim të sheriatit.

Përpos kësaj, metodologjia e Kuranit përputhet me realitetin. Nëse tematika është juridike, atëherë fjala është e thukhtë dhe precize. Nëse tematika ka të bëjë me çështje të besimit (akides) ose që ka të bëjë me adhurim, ose që ka të bëjë me fuqinë e Allahut, ose që përshkruan dënimin në botën tjetër, shprehjet janë impresionuse, të cilat dridhin zemrat, zgjojnë ndjenjat dhe nxisin mendjet.

Ata kanë qenë më oratorë, ndërsa poezitë e tyre kanë qenë të pakta, sikurse janë regjistruar poezitë e tyre të njohura. Tematikat e tyre kanë qenë të ngushta. Nuk kanë folur për lartësinë qiellore, as për botën tjetër, as për pastërtinë morale, e as për çiltërsinë shpirtërore, por thurnin vargje për prejardhjen e tyre fisnore.

Sa i përket Kur'anit, tematikat e tij kanë qenë gjithëpërfshirëse, ligjet e drejta dhe të plota, sqarimet e drejta për çdo qëllim të sheriatit. Përpos kësaj, metodologjia e Kur'anit është në përputhje me realitetin. Nëse tematika ka qenë legjislative, atëherë shprehja ka qenë e precizuar dhe koncize. Sqarimi i qetë, nëse tematika ka qenë tematikë e besimit, ose e adhurimit, ose për të treguar fuqinë e Allahut, ose kërcënimi për botën tjetër, ose frikësim për dënim, atëherë metodologjia e ligjërimit ka qenë impresionuese që dridhë shpirtrat, prek ndjenjat, zgjon mendjen dhe lëviz trupin.

2. Atë që e zbulon shkenca, është vërtetuar në Kur'an

Kur'ani ka sinjalizuar disa të vërteta shkencore, pasi veç ka paraqitur krijimin e qiejve dhe të tokës, krijimin e njeriut, lëvizjen e planeteve dhe sistemin qiellor, si argument për ekzistimin e Allahut dhe Jëshmërinë e Tij.

Ka përkujtuar njerëzit për Madhësitinë dhe begatitë e Tij. Prej ajeteve Kur'anore kuptohen ligji qiellor dhe ligjet natyrore. Çdo zbulim shkencor i çdo kohe ka vërtetuar atë që e ka thënë Kur'ani. Kjo përsëritet në të gjitha fushat, sa herë që në shkencë bëhen zbulime të natyrave të

ndryshme. E vërtetë është thënia e Zotit të Lartmadhëruar ku thotë: **“Thuaj: a po e shihni se po të ishte (Kur’ani) prej dikujt tjetër, pos Allahut, pastaj ju do ta kishit mohuar atë, po kush është më i humbur se sa ai i cili është në humbje të thellë. Ne do t’ju tregojmë argumentet tona në horizont si edhe në vetë ata, deri sa t’u bëhet krejtësisht e qartë se (Kurani) është i Vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt të jetë për çdo send dëshmitar”** (Fusilet, 52)

E gjithë kjo nuk është prej qëllimeve bazore të Kur’anit, por është edhe libër ligjësor; mirëpo në mes rreshtash tregon edhe ato çështje që i përmendëm. Siç tregon Zoti i Lartmadhëruar në shumë ajete:

“Dhe ne kemi dërguar erërat për bashkëdyzim” “Për t’iu dhënë pemëve fruta”;

“E ne shohim ata që kanë mohuar se qiejt dhe toka kanë qenë një tërësi e përbashkët, e ne i ndamë në mes tyre. Dhe prej ujit kemi bërë çdo gjë të gjallë”. Ky ajet tregon për teorinë e kozmosit pas shpërthimit të madh atomik.

Tregon për formësimin e tokës: **“A nuk shohin se Ne i shkojmë tokës në atë mënyrë që e pakësojmë në anët e saj”.**

Tregon se toka ka formën elipsoide. **“E shndërron natën në ditë dhe e shndërron ditën në natë”.**

Tregon për rrotullimin e tokës, sepse fjala shndërrim tregon për trupin qiellor (tokën) që rrotullohet.

Të gjitha këto ajete dëshmojnë atë që ka zbuluar shkenca bashkëkohore, të cilat zbulime nuk i kanë ditur muslimanët më parë. Çdo herë kur është bërë ndonjë gabim në teorema, e pastaj ato janë përmirësuar, ajetetet vetëm janë komentuar për përafrimin e atyre zbulimeve.

3. Lajmërimi për të ardhmen, të cilën nuk e di askush, përpos të Diturit të së fshehtës.

Kur'ani ka paralajmëruar për ndodhitë që do të ndodhin në të ardhmen, të cilat askush nuk i ka ditur. Shembull: Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“ELIF LAM MIMË. Romakët u mundën. Në tokën më të afërt, mirëpo pas humbjes, ata do të fitojnë brenda disa viteve”**.

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Vërtet, Allahu do ta bëjë realitet ëndrrën e vërtetë (të cilën Ai ia shfaqti të Dërguarit të Tij). Vërtet, ju do të hyni në Mesxhidul Haram (Qabe) nëse dëshiron Allahu të sigurt”**.

Në Kur'an ka tregime për popujt e lashtë të cilëve sot nuk u shihen gjurmët, e as nuk ka burime të tjera për ta, gjë që tregon se Kur'ani është prej Allahut të Lartmadhëruar. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Këto janë lajmet, të cilat po t'i shpallim ty, ti nuk i ke ditur, por as populli yt nuk i ka ditur më parë këto lajme”**.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Ti nuk ke qenë në kodrën Turë kur e kemi thirrur, por kjo është mëshirë prej Zotit tënd, për t'ia tërhequr vërejtjen popullit me atë çka të kemi shpallur ty”**.

Fjalë impresionuese dhe alegori të fuqishme

Në Kur'an ka shprehje, të cilat veshi as që i ka dëgjuar më parë dhe të cilat nuk mund t'i dëgjojë as pas tij. Shprehjet e tij janë të nivelit të fuqishëm stilistik. Këtë e vëren ai i cili ka shije të gjuhës arabe, shije të formulimit të shprehjeve, të tregimit të tregimeve, argumentimit, debatimit në vërtetim të besimit dhe për mposhtjen e çdonjerit për çfarëdo krijimi poetik. Në Kuran mund të hasësh shprehje, të cilat janë në përputhshmëri me ajetin, ashtu që ai ajet të ketë ndërlidhshmëri me të njëjtat shprehje në ajetet tjera. Edhe pse njerëzit i përdorin të njëjtat shprehje, prapëseprapë ata dorëzohen dhe e ndiejnë veten të paafte,

thjesht dorëzohen për të thurrur vargje te tilla, nga shkaku se ajetet janë të thurrura nga nga dijetari i fshehtësive (Allahu), ndërsa vargjet tjera nga njeriu, i cili nuk ka mundësi dhe aftësi t'i shprehë ato. Kush deshiron që të thellohet në këtë lëmi, le të lexojë librin **“Keshaf”** të autorit Zamahsheri, pastaj librin **“Delailul ixhaz ve esrarul belaga”** të autorit Xherxhaniju, pastaj librin **“Iëxhazul Kuran”** të autorëve El Kadij el Bakilani dhe Kadij el Ajad dhe librin e kohës së sotme të dijetarit Rafiij me titull **“Iëxhazul Kuran”**.

Ka edhe forma të tjera të mrekullive të Kuranit, si p.sh. Metodologjia e Kuranit, e cila është specifike e vetme e Kuranit, e cila nuk është as poezi, as poemë e as prozë, përpos kësaj gjithëpërfshirja legjislativë dhe stili i lartë në ligjësim, të cilat do t'i sqaroj në temën **“Ligjet e Kuranit”**.

Kjo dhe....disa arabë, të cilët kanë qenë të humbur prej Allahut, kanë tentuar ta kundërshtojnë Kuranin, por nuk kanë arritur asgjë dhe kanë mbetur duarthatë; ata nuk kanë sjellë diçka të veçantë, e cila ia vlen të përmendet, sepse fjalimet e tyre kanë qenë të cekëta dhe të dobëta, të pandërlidhura dhe të pakuptimta dhe që edhe vetë ata e kanë ditur se i kanë vargjet e pakuptimta, por që kanë dëshiruar të përfitojnë masën me mashtrime. Prej tyre është Musejleme el Kedhdhabi, Ajheletu bin Keabi dhe Tahijlete el Esedi. Ka pasur prej poetëve, të cilët janë udhëzuar më vonë në rrugë të drejtë; prej tyre mjafton të përmendim thënien e Velid bin Mugiresi, cili më herët kishte qenë armik i përbetuar i Muhamedit a.s, i cili për Kuranin ka thënë: ***”Në të (Kuran) ka ëmbëlsirë, e mbi të lartësi, e larta e saj është frytdhënësia, e poshtmjia e saj ushqyesia. Nuk ka dhe nuk mund të ketë asgjë mbi të, sepse nuk është fjalë njeriu.***

Sa i përket ndikimit të Kuranit në zemra dhe mbizotërimit të tij në shpirtëra, këtë nuk mund ta mohojë askush, qoftë poet, qoftë shkenctar, përpos që të deklarojë se: është fjalë e Zotit të Lartmadhëruar pa fillim. Pejgamberi s.a.v.s e ka përshkruar kështu:”(Kurani) është litar i fortë i Allahut, dritë e qartë, shërues për nevojtarët, siguri për kerkuesit e sigurisë, shpëtim për pasuesit. Në të nuk ka shtrembërime, por është i drejtë.²⁸

Ibn Mesudi ka thënë:”Nëse dëshironi dituri kërkojeni në Kuran, sepse në të është dituria e të mëparshmëve dhe e të mëvonshmëve”.

Ligjet e Kur'anit

Ligjet e Kur'anit janë të shumëllojshme.²⁹

1. Ligjet e besimit: të cilat janë të ndërlidhura me atë që i ngarkuari e ka obligim të besojë Allahun, në melekët e Tij, në librat e Tij, në pejgamberët e Tij dhe në ditën e gjykimit

2. Ligjet e moralit, të cilat janë të ndërlidhura me atë që i ngarkuari të pajiset me vlera njerëzore dhe të zhvishet nga imoraliteti.

3. Ligjet praktike: të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e të ngarkuarit, me fjalët e tij, me sjelljet e tij, me aktet dhe veprimtaritë në përgjithësi. Ky lloj ka të bëjë me ligjet e fikhut të Kur'anit, e që shkenca e usulit ka këtë qëllim, që është dy llojesh.

a. –Ligjet e adhurimit; siç janë namazi, agjërimi, zekati, haxhi, përбетimet e adhurimet tjera me të cilat kihet për qëllim organizimin e raporteve të njeriut me Zotin e tij.

b. –Ligjet e raporteve ndërnjerëzore, si f.v. aktet, dënimet, pra, në përgjithësi, organizimin e jetës në mes të njerëzve, pa marrë parasysh raportet se a kanë të bëjnë në mes të njerëzve si individ, apo grupe-grupe.

Këto ligje janë si vijon:

1. Ligjet e statusit personal. Janë ligje që kanë të bëjnë me familjen, duke filluar prej krijimit të familjes, pra martesën, raportet në mes tyre, e pastaj raportet farefisnore.

2. Ligjet e të drejtës qytetare, të cilat kanë të bëjnë me raportet në mes të njerëzve, si shitblerja, qiramarrja, sigurimi, borxhi, mbajtja e premtimit, kryerja e obligimeve. Me këto ligje kihet për qëllim organizimin e raporteve të individëve në aspekt material dhe të drejtës qytetare.

3. Ligjet kundërvajtëse. Këto ligje kanë të bëjnë me veprat për të cilat i ngarkuari dënohet. Me këto ligje kemi për qëllim ruajtjen e jetës së njerëzve, pasurinë e tyre, të drejtën e tyre, nderin e tyre. Me këto ligje definohen marrëdhëniet e individit me individin dhe të individit me shoqërinë.

4. Ligjet e krimeve penale. Këtu bëjnë pjesë ligjet që kanë të bëjnë me gjykimin e njerëzve në mes vete, dëshminë, përbatimin. Me këto ligje bëhet organizimi i jetës, ashtu që vendoset në peshojë drejtësia në mes të njerëzve.

5. Ligjet kushtetuese. Janë ligje që kanë të bëjnë me rregullat bazë kushtetuese. Kihet për qëllim definimi i marrëdhënieve të qeveritarit dhe të qeverisurit, si dhe përkufizimin se çfarë të drejtash kanë individët dhe shoqëritë.

6. Ligjet shtetërore. Janë ligje që kanë të bëjnë me shtetin në raport me çështjet tjera. Ky është kodi ndërkombëtar i përgjithshëm, veprimtaria me jomuslimanët të cilët jetojnë në shtetin islam, e ky është kodi ndërkombëtar me status special. Me këto ligje kihet për qëllim përcaktimi i ligjeve të shtetit islam me shtetet tjera, si në luftë, ashtu edhe në paqe, dhe përcaktimi i marrëdhënieve të muslimanëve me jomuslimanët në vendet islame.³⁰

7. Ligjet ekonomike dhe financiare. Janë ligje që kanë të bëjnë me pasurinë e qytetarëve, të drejtat, përgjegjësitë dhe obligimet e qytetarëve ndaj shtetit në shtimin e buxhetit shtetëror. Me këto ligje kihet për qëllim rregullimin e raporteve në mes të të pasurve e të varfërve dhe në mes të shtetit e qytetarëve.

Këtu bën pjesë buxheti shtetëror, me fjalë të tjera pasuria shtetërore e përgjithshme dhe e veçantë si “**Ganime**” dhe “**enfalë**” (pasuria prej lufte) dhjetëpërqindëshi, **haraxhi**, xehet e pasuritë natyrore dhe pasuria e qytetarëve, si zekati, sadakaja, përbitimet dhe borxhet; pasuria familjare: si shpenzimet ndaj familjes, trashëgimia dhe testamenti; pasuria e qytetarëve, si: profiti tregtar, i qirasë, profiti nga shoqëritë aksionare dhe të gjitha fitimet tjera nga shërbimet prodhimit dhe të ardhurat prej dënimeve me të holla, si fitimi prej kefareteve, dijeve dhe fidjes.

Kur’ani këto ligje ose i ka shpjeguar dhe i ka definuar detajisht, ashtu që e ka shpjeguar çdo imtësi, si f.v. në ibadete, në statusin personal dhe në trashëgimi. Urtësia e këtyre ligjeve është çështje adhurimi dhe, me një fjalë, mendja nuk mund të ndërhyjë në urtësinë e këtyre ligjeve dhe se në këto ligje nuk ka reforma, as evoluim, e as zhvillim në bazë të zhvillimit të jetës së njeriut.

Ose: Kur’ani bën sqarim të përgjithshëm, ashtu që paraqet rregullat e përgjithshme dhe parimet bazë, e nganjëherë paraqet edhe detaje të

atyre rregullave. Urtësia në këto ligje është t'i bëhet hapësirë dijetarëve të sqarojnë dhe të vendosin atë që është më e përshtatshme dhe në harmoni me nevojat e dobisë dhe që plotëson domosdoshmërinë dhe zhvillimin në bazë të gjeneratave dhe vendeve. Në këtë mënyrë realizohet përjetshmëria e sheriatit islamik dhe përshtatshmëria e saj për çdo kohe dhe për çdo vend. Shembull për këtë është se Zoti i Lartmadhëruar ka vendosur rregullat e përgjithshme të ligjeve qytetare. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“O ju, të cilët keni besuar, mos e hani pasurinë e juaj mes jush me padrejtësi, përpos nëse është tregti në pajtim mes jush”**. Zoti i Lartmadhëruar e ka lejuar shitblerjen, e ka ndaluar kamatën, e ka lejuar pengëzimin pasi që i ka sqaruar ligjet për muxhtehidët, varësisht çka e shohin se ç'është më e dobishme për ta.

Sa i përket ligjeve kushtetuese, Zoti i Lartmadhëruar ka vendosur bazat e ligjit islam me thënien **“Dhe konsultohuni për çështjet”** dhe **“çështja e tyre është se konsultohen mes vete”**.

Sa i përket ligjeve shtetërore në nivel ndërkombëtar, Zoti i Lartmadhëruar e ka sqaruar bazën në mes të muslimanëve dhe të tjerëve: **Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë Allahu i do të drejtët. Allahu ju ndalon t'i bëni miq ata që luftojnë kundër jush, për shkak të fesë, dhe ju dëbojnë nga vatrata tuaja, si dhe mbështesin të tjerët që t'ju dëbojnë. Kushdo që i bën ata miq, është punëmbropshtë.** (Mumtehinë 8,9)

Sa i përket ligjeve të luftës dhe të paqes, Zoti i Lartmadhëruar ka vendosur rregullin **“Dhe luftoni në rrugë të Allahut ata të cilët ju luftojnë juve, e mos e teproni. Vërtet, Allahu nuk i do tepruesit”**

Baza e të gjitha këtyre ligjeve është një ajet në Kur'anin fisnik: **Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, mirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon në mënyrë që të jeni të kujdesshëm dhe të mendoni..Zbatoni besëlidhjen e Allahut, kur ta merrni mbi vete, dhe mos e thyeni betimin, pasi e keni bërë atë, sepse Allahun e keni bërë**

dorëzënës in tuaj. Vërtet, Allahu e di se çka vepron. (en-Nahl; 90,91)³¹

Sqarimet e të gjitha këtyre çështjeve janë në disponim të dijetarëve të umetit dhe udhëheqësve të sinqertë, të cilët i plotësojnë kushtet ashtu siç i parasheh Kushtetuta e famshme islame.

Treguesi i Kur'anit për ligje

Kur'ani edhe pse është argument i prerë, sepse tek ne ka ardhur në mënyrë të përpiktë dhe i plotësuar me të gjitha kushtet të cilat i kemi sqaruar, prapëseprapë tregimi tekstual i ligjeve ndonjëherë është tregim i prerë dhe i sigurt, e ndonjëherë tregim jo i prerë.³²

Teksti tregues i prerë është fjalë e ardhur në Kur'an, i cili ka kuptim të përkufizuar dhe i cili ka vetëm një kuptim, si f.v.: ajetet e trashëgimisë, hudutit dhe kompensimeve, siç është ajeti: **“Allahu ju urdhëron për trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave; nëse trashëgimtarë janë dy e më tepër femra, atyre u takojnë dy të tretat nga trashëgimia; nëse është një femër e vetme, asaj i takon gjysma e pasurisë”**. (en-Nisa, 11)

Pastaj ajeti: **“Prostitutën dhe prostitutin, secilin prej tyre, shkopone me nga njëqind shkopinj”** (en-Nisa, 1)

Pastaj ajeti: **“Ata të cilët bëjnë dhihar (thonë se shpina e jote, oj grua, është si shpina e nënës sime) me gratë e tyre, pastaj pendohen në atë çka kanë thënë, le të lirojnë një rob para se të kontaktojnë me ta”**.

Dy të tretat, një e dyta, njëqind dhe lirimi i robit janë fjalë që tregojnë formë të prerë dhe nuk lejojnë kuptim tjetër jo të sigurt.

Teksti i cili tregon dy e më shumë kuptime: është një tekst i ardhur në Kur'an, i cili ka më shumë se një domethënie, i cili lë hapësirë të interpretohet, siç është fjala dykuptimëshe **“Kur’ë”** –periodë kohore.

Në ajetin Kur'anor **“Të shkurorëzuarat le të presin vet në veten e tyre tri perioda”**. Fjala **“Kur’ë”** –periodë në gjuhën arabe, është fjalë me kuptim të dyfishtë, pastrim dhe menstruacion. Dhe, ka mundësi që të jetë tre pastrime, por ka mundësi të jetë tre menstruacione. Pra, fjala tregon mundësinë e njërës prej këtyre dy kuptimeve jo të sigurtë e jo në mënyrë të prerë.

Kur’ani sqarues

Pasi që Kur’ani është sqarues për gjithçka, siç është fjala e Zotit të Lartmadhëruar **“Dhe Ne në libër (Kur’an) nuk kemi lënë asgjë mangut”**. nuk ka për qëllim që t’i sqarojë të gjitha detajet dhe të gjitha çështjet në imtësi dhe detajet e çështjeve sekondare, të ngjarjeve dhe të çështjeve sekondare, të ngjarjeve dhe të çështjeve, por në të shumtën e rasteve sqaron çështjet e përgjithshme, e jo çështjet e veçanta, në mënyrë globale e jo precize. Kur’ani ka sinjalizuar për urtësinë e kësaj për t’u dalluar sheriatit islam, si ligj i veçantë dhe i përshtatshëm harmonik, i përgjithshëm dhe i gjerë, për të plotësuar nevojat e njerëzve të vendeve të ndryshme dhe në kohëra të ndryshme, ashtu që mos të paraqitet shfuqizimi i ligjeve dhe të mos reformohet e të mos ndryshohet me ndryshimin e kohërave. Po, edhe për të nderuar umetin islam, ashtu që Allahu mos t’i bllokojë mendjet e pjesëtarëve të saj dhe mos t’i sqarojë imtësitat, ashtu siç ka qenë rasti me popujt e mëhershëm.³³

Pasi që çështja është kështu, nuk lejohet të nxirren ligjet prej Kur’anit pa u rikthyer në sunetin sqarues, i cili shpjegon atë që nuk është shpjeguar. E, nëse nuk ka sqarim në sunet, i orientohemi interpretimit të dijetarëve të mëhershëm e të drejtë.

Nëse edhe aty nuk gjejmë sqarim, atëherë gjykojmë në bazë të kuptimit të gjuhës së pastër arabe. Për këtë arsye, ne e dimë numrin e rekateve në namaz, përqindjen e zekatit, rregullat e haxhit, ligjet e xhihadit, dhe kushtet e veprimtarive të ndërsjellta, të dënimeve, kushtet e nikahit prej sunetit të vërtetuar nga Pejgamberi s.a.v.s..

Ndoshta dikush nuk mund ta kuptojë thënien e Zotit të Lartmadhëruar: **“Ky është sqarim për njerëzit”**, sa i përket fillimit të disa sureve dhe shkronjave të alfabetit arab, sepse ato shkronja të cilat nuk kanë kuptim dhe në ato shkronja nuk mund të kuptohet, sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe nuk mund ta dijë interpretimin e tij, përpos Allahut, dhe të thelluarit në dituri thonë ne besojmë në të”**. Shkronja **“vav”** është shkronjë e fillimit dhe e rifillimit. Në Kur’an ka ajete të pakuptuara dhe kjo është çka paraqitet mundësia e të mundshmes apo sa i përket cilësive të Allahut, çka jep mundësi të jetë fjalë alegorike dhe joalegorike, si ajeti për dorën e Allahut, fytyrën, vendosjen e Tij në Arsh dhe lajkatimi i Allahut.

I kundërpërgjigjemi këtyre çështjeve me sa vijon:

Shkronjat e alfabetit në fillim të sureve nuk mund të pranohet se janë shkronja pa kuptim, sepse ato janë shkronja të emërimit të sureve. Thuhet sureja **“Ja-Sijnë”**, sureja **“Ta Ha”**. Ose: mund të jetë për t’i trazuar arabët, për të dëgjuar dhe për t’i vërë veshin Kur’anit, sepse kjo nuk ka qenë traditë e tyre. Ose: mund të jetë alegori për të gjitha shkronjat tjera të alfabetit arab, të cilat janë shkronja të gjuhës së tyre dhe vërejtje se ku ligjëron në gjuhën e tyre me shkronjat e tyre.

Pra, janë shkronja të sfidimit, që të angazhohen dhe të sjellin një Kur’an të ngjashëm, por prapëseprapë do të jenë të paaftë, edhe pse Kur’ani është me të njëjtat shkronja të gjuhës së tyre, me të cilat shkronja thurrrin poezi, fjalë, shkruajnë, ligjërojnë dhe flasin.

Ndërsa, ajeti **“Dhe të thelluarit në dituri”**, **“vavi”** është shkronjë lidhore, siç kanë thënë usulijinët. Pjesa e ajetit **“Thonë Ne besojmë në të”** është ndajfolje e **“të thelluarve në dituri”**. E, kjo është posaçërisht për ta shikuar te Allahu i Lartmadhëruar. E veçantë është mendja, e cila përqendrohet dhe i nënshtrohet Allahut të Lartmadhëruar.

Imam Gazaliu thotë: Nëse thuhet se: A është shkronja **“vavun”** lidhore apo për emrin **“Allah”**, i përgjigjemi: që të dy variantet janë të mundura. Nëse qëllimi me të është për ditën e kijametit, ndalja është më prioritare në të kundërt, më prioritare është që **“vavi”** të jetë lidhore. Pra,

shihet qartë se Allahu i Lartmadhëruar nuk i drejtohet arabëve për atë që asnjëri nuk ka njohuri dhe nuk ka mundësi që ndonjë njeri të dijë.

Sa i përket **“ajetet e paqarta”**, nuk është qëllimi me të për ajetet në kuptim të drejtë, për fjalët kuptimplota apo alegorike, por qëllimi është për alegoritë të cilat i kuptojnë besimtarët arabë, të cilët vërtetojnë dhe besojnë Allahun me të cilin nuk ka të ngjashëm. Dhe, ajo është interpretuar me kuptime dhe alegori, të cilat përshtaten me kuptimin e gjuhës arabe.

Dijetari Shevkaniju thotë: Të ndaluarit në pjesën e ajetit përpos Allahut, kjo përkon me komentimin se ka ajete të paqarta, sepse Allahu me diturinë e Tij të pakufishme na jep dituri, ndërsa ne e pranojmë atë në atë masë që Ai na dhuron dituri.³⁴

Përpos kësaj, sqarimi i Kur'anit është në përputhshmëri me atë që Kur'ani është mrekulli dhe ka oratori mrekullore. Ndalesa në diçka mund të bëhet:

- Ose në formën e ndalesës, si f.v. **“Dhe mos iu afroni prostitucionit.”**

- Ose nëpërmjet lajmërimit se është e dëmshme, si f.v. ajeti **“Dhe mos llogaritni se ata të cilët janë koprrac në atë që Allahu u ka dhënë prej të mirave të Tij, është e dobishme për ta, përkundrazi është e dëmshme për ta.”**

- Ose nëpërmjet formës se nuk është mire si f.v. ajeti: **“Nuk është mirë që të hyni në shtëpi (të huaja) nga ana e pasme e tyre.”**

- Ose në formën duke përkujtuar se veprimi sjell të keqe ose dëme, si f.v. **në mëkat,**

- Ose në xhehenem. Shembull të kësaj kemi ajetin: **“Kjo është më mirë që të mos bëni padrejtësi.”**

Kërkesa për diçka mund të bëhet:

- Ose mund të bëhet në formën urdhërore, shembull **“Falni namazin dhe jepni zekatin.”**

- Ose nëpërmjet foljes **“Ju është bërë obligim”** .
- Ose nëpërmjet foljes **“Ju është regjistruar detyrim”**. *Shembull: “Nuk ka dyshim se namazi për besimtarët është i regjistruar si obligim në kohë të caktuar”*.
- Ose nëpërmjet të formës se veprimi sjell dobi. *Shembull: “Kjo është më e dobishme për ju”*.

Nga kjo që thamë, dijetari i Usulit patjetër duhet të nxjerrë ligjet e sheriatit prej Kur'anit në atë që vëren mënyrën e premtimit, ose mënyrën kërcënimit.

Këto janë disa prej rregullave të nxjerrjes së ligjeve:

1. Çdo veprim që Allahu e ka ngritur, e ka lavdëruar, ose e ka dashur, ose çdo veprim që ka cilësi të fuqishme, ose në çdo çështje që është betuar, ajo ligjësohet si vaxhib (obligative), ose edukative.
2. Çdo veprim që Ligjvënësi ka kërkuar të mos veprohet, ose e ka nënçmuar, ose e ka mallkuar, ose vepruesin e përshkruan si kafshë, ose si shejtan, ose veprimi është fëlliqësirë, ose kryeneçësi, ai veprim nuk lejohet dhe është haram ose mekruh.
3. Çdo gjë që Allahu e ka lejuar, ose nuk e konsideron se është mëkat, është e lejuar (Mubah).³⁵

Disa rregulla të Usulit që kanë të bëjnë me Kur'anin

Dijetari el-Hudarij dhe të tjerët kanë sjellë rregullat, të cilat janë bazë e përgjithshme e Kur'anit, e ato janë:³⁶

1. Kur'ani është bazë e sheriatit dhe burim kryesor, te të cilat kthehen të gjitha argumentet tjera. Pastaj, është suneti, e pastaj thënia e dijetarëve të parë, të cilët sqarojnë këto argumente. Intelektuali me

mendje të shëndoshë mund të kuptojë ajetet në bazë të ëmbëlsirës së gjuhës arabe.

2. Patjetër duhet ditur shkaqet e zbritjes së ajeteve të Kur'anit, sepse Kur'ani ka zbritur pjesë-pjesë, varësisht prej ngjarjeve dhe rrethanave. Argument për këtë është hulumtimi në dy çështje:

Çështja e parë: - Nuk mund të kuptohet mrekullia Kur'anore, pa i kuptuar, në rend të parë, rrethanat në të cilat ka zbritur legjislacioni Kur'anor, pa u kuptuar mënyra e ligjërimit, ligjërimi ndaj të ligjëruarit, apo vetë ligjërimi, sepse të kuptuarit e fjalës ndryshon në bazë të rrethanave kur është thënë, edhe pse është thënë, siç është rasti me **formën pyetëse**: mund të jetë për të vërtetuar një çështje, por mund të jetë edhe për të tërhequr vërejtjen.

Ose: me **formën urdhërore**. –Ndonjëherë është për kërcënim, ndonjëherë për lejim.

Me këtë kuptohet qartë se shkaqet e zbritjes së Kur'anit janë faktorë konkretë ose abstraktë, në të cilat bëhet mbështetja për të kuptuar Kur'anin drejt dhe thelbësisht dhe që kuptimi të jetë më afër ngjarjes, më praktik dhe më i përpiktë.

Çështja e dytë: Mosnjohja e shkaqeve të zbritjes së Kur'anit sjell vështirësi në të kuptuar dhe dyshim. Kjo shihet qartë në dy shembujt që do t'i sjellim në vijim.

Transmetohet se Mervan bin Hakemi nuk e ka kuptuar ajetin: **“Atyre të cilëve u është dhënë (libri), mos i llogaritni se janë duke u krenuar dhe duke u lavdëruar për atë që nuk e kanë bërë (e thonë se e kanë bërë). Mos mendoni se do t'i shpëtojnë dënimit”**.

Dhe e dërgon një njeri te Ibni Abasi dhe i thotë: Nëse çdo njeri gëzohet me atë që i është dhënë dhe që falënderon për atë që nuk i është dhënë, atëherë do të dënoheshim që të gjithë. Atëherë Ibni Abasi thotë: Ky ajet nuk është për ju. Por, ka zbritur kur Pejgamberi s.a.v.s. i ka thirrur jehudët dhe i ka pyetur për diçka. Ata fshehin të vërtetën dhe përgjigjen me të pavërtetën, ndërsa pretendonin se janë përgjigjur për çka janë pyetur. E, për këtë mashtrim janë krenuar, janë lavdëruar dhe janë gëzuar për përgjigjen e vërtetë. Pastaj ia lexon ajetin: **”Pastaj Allahu ka**

marrë besatimin prej atyre, të cilëve u është zbritur libri, që librin t'ua sqarojnë njerëzve e të mos e fshehin, e ata e kanë hedhur pas shpine dhe kanë përfituar prej saj përfitime të vogla. Mjerë për ta se çka kanë përfituar”. E, ajeti ka këtë qëllim “Mos i llogaritni”

Kur ia sqaroi këtë, u hoq dyshimi, gjë që tregon se në kuptim të jashtëm ajeti nuk e ka atë qëllim.

Transmetohet se Ibni Kudame Ibn Met'unë është akuzuar për alkoolizëm. U paraqitën dëshmitë të Omeri r.a. dhe

Omeri i thotë: O Kudame do të të dënojë me të rëna.

Kudame i thotë: Për Zotin, po të kisha pirë alkool, siç thonë, ti nuk do të kishe të drejtë të më dënosh, sepse Allahu i Lartmadhëruar thotë: **”Nuk ka gjunah për ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, për atë që kanë ngrënë, për sa kohë që ata ruhen besojnë dhe bëjnë vepra të mira, e sërish ruhen dhe besojnë, e vazhdimisht ruhen dhe bëjnë vepra të mira. Allahu i do punëmirët”**. (El Maide,93) E, unë jam prej këtyre, sepse kam luftuar me të Dërguarin e Allahut në Bedër, Uhud dhe Hendek. Të gjitha këto janë dëshmi të këtij ajeti.

Omeri thotë: “A po e dëgjoni çka po thotë?”.

Atëherë Ibn Abasi thotë: Këto ajete kanë zbritur si arsyetim për të kaluarit (gjeneratat e kaluara) dhe argumenton për atë që kanë mbetur gjallë. Arsyetim për të kaluarit, sepse ata kanë vdekur dhe janë takuar me Allahun para se të ndalohej alkooli, ndërsa argument për të tjerët, sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë: **”O besimtarë! Me të vërtetë pijet alkoolike, bixhozi idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta të shejtanit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni”**. el-Maide,90

Edhe nëse janë prej atyre të cilët besojnë dhe veprojnë punë të mira, pastaj janë të devotshëm e besimtarë, të devotshëm e bamirës, për këta e ka ndaluar Allahu të pinë alkool.

Omeri thotë: “O Ibn Abas e the të vërtetën”.

Kjo tregon se ajeti nuk e ka atë qëllim, i cili shihet nga ana e jashtme e tij.

3. Patjetër duhen zakonet dhe traditat e arabëve, njohuritë e tyre, mënyrën e të folurit të tyre, metodologjinë ligjëruese në momentet ku ka

zbritur Kur'ani, sepse mosnjohja e këtyre çështjeve ndikon në moskuptimin e ajetit. Kjo ilustron me shembujt në vijim:

a. –Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Plotësoni haxhin dhe umren për Allah”**. Ky është urdhër për plotësim, e jo për haxhin, sepse arabët kryenin haxhin edhe para islamit. E, disa rregulla islami i ka ndryshuar, e disa i ka shtuar, siç është rasti i qëndrimit në Arafat, gjë që tregon, gjithashtu, edhe obligueshmërinë e haxhit dhe të umres.

b. –Zoti i Lartmadhëruar na mëson se si ti lutemi atij: **“O Zoti ynë, mos na dëno për atë që harrojmë ose gabojmë”**. Ebu Jusufi thotë: **“për idhujtari”**, sepse ata vetëm se e kishin pranuar islamit, e më herët kishin qenë idhujtarë. E, ndonjëri dëshiron në besimin në një Zot, e ai gabon e bëhet pabesimtar. Allahu i ka falur ata për idhujtarinë e mëhershme. Ai thotë: Ky ajet ka qenë për idhujtari, e jo për shkurorëzim, përбетim, lirim nga robëria, shitblerje, sepse në kohën e tyre nuk ka ekzistuar përбетimi për shkurorëzim dhe lirim të robërisë.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe, vërtetë Ai është Zoti i “yllit shiëra”**. Zoti e ka përcaktuar këtë yll, sepse fisi arab Huzatu e adhuronte. Ebu Kebshete është ai i cili e ka shpikur adhurimin e këtij ylli, e për këtë arsye Allahu e ka përcaktuar këtë yll.

4. Çdo tregim i treguar në Kur'an dhe i përmendur në të, i cili i kundërpërgjigjet, është argument i prerë për të mposhtur atë. *Shembull:* Thënia e Zotit të Lartmadhëruar: **“Thonë: Nuk i ka zbritur asnjë njeriu asgjë”**. E, Zoti iu kundërpërgjigjet: **“Thuaj: Kush e ka zbritur librin me të cilin ka ardhur Musa, si dritë dhe udhëzim për njerëzimin”**.

Shembull tjetër: **“Po sa keq po gjykojnë ata”**. Kur'ani nuk përmend asgjë tjetër, pos atë që është e vërtetë dhe udhëzuese.

Për këtë arsye, disa dijetarë kanë thënë: **“Ligjet para nesh i tregon Kur'ani dhe nuk ka diçka që i mohan është edhe ligj për ne”**

Të tjerët thonë: Edhe pse është e pranueshme se është e vërtetë, prapëseprapë është shfuqizuar me sheriatin tonë.

Duke u bazuar në këtë, të tjerët thonë: Prej pabesimtarëve kërkohen edhe obligimet sekondare të sheriatit tonë. Zoti i Lartmadhëruar thotë për

arsyetimin e tyre: **“Thonë ne nuk kemi qenë prej falësve dhe nuk kemi qenë prej atyre që ushqejnë të varfrit”**. E, nuk ka ajet tjetër që e mohon këtë. Nga kjo, suneti për çështjet që ka heshtur (ka pranuar pa i mohuar me fjalë) Pejgamberi s.a.v.s. llogaritet argument i ligjeve të sheriatit.

5. Argumenti se Kur’ani parasheh domosdoshmëritë, nevojat, mirësitë dhe plotësimet që i sqaron vetë Kur’ani, pa lënë mangut asgjë. Me këtë bëhet e qartë se Kur’ani është vendburim i ligjeve dhe i çështjeve të përgjithshme dhe të tërësishme, të cilat duhet t’i ketë çdo legjislacion. Për këtë arsye, definicioni i Kur’anit më shumë është ligj i tërësishëm dhe i përgjithshëm, se sa i thuktë. Ndërsa, suneti është sqarues i atyre përgjithësimeve dhe sqaron çështjet globale të Kur’anit.

TEMA E DYTË

SUNETI

Hyrje

E kam zgjedhur termin sunet, e jo shprehjen haber e as ether, sepse haberi është sikurse hadithi. Është ajo çka i mbështetet Pejgamberit s.a.v.s. ose sehabiut, ose dikujt tjetër, shprehimisht, veprimtarisht ose vendosmërisht ose atributisht. Ndërsa, etheri është hadith që arrin në rrugë duke arritur te Pejgamberi s.a.v.s., ose është i ndërprerë në rrugë duke arritur te Pejgamberi s.a.v.s. e disa fukaha e kanë veçuar se çka është ndërprerë.

Sa i përket sunetit, janë fjalë, veprat, vendimet dhe atributet e Pejgamberit s.a.v.s.³⁷

Ne do të flasim për sunetin me sa vijon:

- **Definicioni i sunetit,**
- **Llojet e sunetit në bazë të zinxhirit,**
- **Argumenti i sunetit,**
- **Pozita dhe vendi i sunetit në krahasim me Kur'anin,**
- **Medhhebet e sehaveve dhe dijetarëve për ta llogaritur si bazë për të vepruar me haberin e vetmuar, hadithin mursel,**
- **Veprimet e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., disharmoninë në mes të fjalëve tij ne veprat e tij.**

1. Definicioni i sunetit.

Sunet gjuhësisht është shprehje e rrugës dhe e drejtimit normal. Suneti i çdonjërit, çka është e thëna dhe e ruajtura prej tij, pa marrë parasysh se a është e mirë apo e keqe. *Shembull:* Thënia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: **”Kush e trason një rrugë të mirë, ai ka shpërblim të vetin dhe shpërblimin e atyre që veprojnë deri në ditën e kijametit, dhe kush e trason një rrugë të keqe, ai ka gabimin e vet, në rend të parë, e pastaj gabimin e atyre që veprojnë deri në ditën e kiametit”**.³⁸

Te fukahatë sunet është e kundërta e vaxhibit në ibadete, ashtu siç e kemi sqaruar te tematika e ligjit. Ndonjëherë quhet e kundërta e bidatit, si f.v. thënia: Filani është prej pasuesve të sunetit.

Te Usulijnët suneti është çdo gjë që buron nga i Dërguari s.a.v.s. prej argumenteve të sheriatit çka nuk është në Kur'an dhe nuk është mrekulli, e as brenda kornizës së mrekullisë. Me fjalë të tjera: Suneti është çdo gjë që buron nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. prej fjalëve, veprave dhe vendimeve në heshtje. Gjatë kësaj tematike qëllimi është për këtë:

a. Suneti foljor: Janë hadithet të cilat i ka thënë Pejgamberi s.a.v.s. në vende të ndryshme. *Shembull:*

Thënia e tij: ***Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit.***

Pastaj, thënia e tij: ***“Nuk lejohet të dëmtojë, as të dëmtohet askush në islam”***.

Pastaj thënia e tij: ***“Trashëgimtari nuk ka të drejtë në testament”***.

b. Suneti veprimor: Janë veprimet e Pejgamberit s.a.v.s.

Shembull: - **Falja e pesë kohëve të namazit,**

- **kryerja e rregullave të haxhit,**

- **gjykimi që akuzuesi të sjellë dëshmi, e i akuzuari të përбетohet.**

Të gjitha këto do t'i sqaroj te veprimet e Pejgamberit s.a.v.s.

c. Suneti heshtor vendimmarrës: Është kur Pejgamberi s.a.v.s. ka heshtur gjatë një mohimi, veprimi ose të një fjalie, ose të një veprimi, të cilat çështje kanë qenë në prezencën e tij, para tij, në kohën e tij, e që ai e ka dëgjuar. E, vendimi është realizuar:

ose me pajtueshmërinë e tij;

ose me përgëzimin e tij;

ose me bekimin e tij;

ose duke mos e kundërshtuar, por duke heshtur.

Shembull: Të ngrënit e **“Dubit”** në tryezën e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Shembull tjetër: Pranimit i gjykimit të Pejgamberit s.a.v.s. kur Muadh Ibn Xhebeli ka gjykuar për mënyrën e përбетimit.

Shembull tjetër: Gjykimi për thembrën (shputa) se këmba e Usames është prej këmbës së Zejdut, kur ka thënë: **“Vërtet, këto këmbë janë të njëra-tjetrës.”**, gjë që tregon se shputat janë argument për të vendosur farefisën, siç është në medhhebin e Imam Shafij r.a.³⁹

Hanefijtë thonë: Përgëzimi i tij nuk ka qenë dëshmi e gjykimit, mirëpo është dëshmuar për t'i mposhtur hipokritët për thënien e tyre për prejardhjen e Usame bin Zejdut dhe për t'i detyruar që hipokritët ta pranojnë gabimin e tyre në atë se me ghykimin e tyre ata kanë gjykuar gabimisht.

Dijetari Huderij ka thënë: Nuk ka dyshim se kjo është e papranueshme, sepse mohimi i të Dërguarit të Allahut mendimin e hipokriteve shihet qartë se është e vërtetë se ai do të mohonte.

Ndarja e sunetit në bazë të zinxhirit

Te shumica e dijetarëve, ndarja e sunetit në bazë të zinxhirit është dy llojesh:

1. Suneti mutevatir; dhe

2. Suneti i vetmuar.

Pa marrë parasysh se a është haber i vetmuar i pranuar (*haber i cili ka më shumë se tre transmetues*), siç kanë deklaruar Amediju dhe Ibni Haxhibi, apo i papranuar (*është hadithi që ka më pak se tre transmetues*), edhe në shekullin (gjeneratën) e dytë ose të tretën, në atë masë, sa që transmetimi është i besueshëm dhe nuk ka shansë që të jenë pajtuar për përgënjeshttrimin.⁴⁰

Te Hanefijtë, në bazë të zinxhirit, suneti ndahet në tri lloje:

1. Suneti mutevatir,

2. Suneti meshhurë dhe

3. Suneti ahad.⁴¹

Këto tri lloje do t'i sqarojmë me sa vijon:

E para: Suneti mutevativir.

“**Tevatur**” gjuhësisht do të thotë kontinuitet, vazhdimësi. Thuhet: Është rreshtuar populli, kur ka ndodhur njëri pas tjetrit, me një distancë mes njeri-tjetrit. Zoti i Lartmadhëruar thotë: “**Pastaj ne kemi dërguar të dërguarit tanë të rreshtuar njeri pas tjetrit**”.

Në terminologji do të thotë: **Çdo haber (lajm), i cili ka transmetues tepër të madh, sa që është e pamundur që të gjithë të jenë dakorduar të gënjejnë.**

Suneti mutevativir. – Është suneti të cilin e kanë transmetuar nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. një shumicë transmetuesish, që normal është e pamundur që ato të jenë dakorduar të gënjejnë në tri gjeneratat e para: gjenerata e shabeve, gjenerata e tabiinjëve dhe gjenerata e tebei tabiinjëve,⁴² sepse pas këtyre gjeneratave transmetimi është bërë nëpërmjet regjistrimit. Sa i përket asaj që nuk kanë mundur të dakordohen për gënjeshtëri, pra për shkak të emanetit të tyre, për shkak të orientimit të ndryshëm të tyre dhe për shkak të jetës së tyre në vende të, në këtë kushtëzohet që në të gjitha gjeneratat, duke filluar prej lajmëruesit e deri te i lajmëruari, të jetë transmetim i drejtë. *Shembull:* Transmetimi i Kur’anit, po ashtu sunetet praktike, si .f.v. rekatet e namazit, rregullat praktike të haxhit, përcaktimi i përqindjes së zekatit, mënyra e abdesit e të ngjashme, të cilat muslimanët i kanë pranuar nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. me të shikuar ose me të dëgjuar, pa kurrfarë ndryshimi në mes gjeneratash dhe vendesh. Ndërsa, sa i përket suneteve foljore, ato janë të pakta, si f.v: “**Për trashëgimtarin nuk lejohet të lihet testament**”.⁴³ Te disa vërtetues të këtij hadithi,

ose hadithi: “**Kush me qëllim gënjen për mua, le të përgatisë vendin e tij në zjarr**”.⁴⁴

Po ashtu, hadithi: “**Mjerë për të lëshuarit e mëngëve të këmbës, të cilët do të hynë në zjarr**”.⁴⁵

Dispozita e hadithit mutevatir: -Të gjithë dijetarët janë të pajtimit se është argument i prerë nga Pejgamberi s.a.v.s., absolutisht është i saktë, dhe mospranuesi, i cili mohon, është mohues. Kjo tregon se ne e dimë domosdoshmërinë që ekzistojnë vende të largëta në rruzullin tokësor dhe personalitete të ndryshëm, si dijetarët dhe historianët.⁴⁶

- Disa dijetarë e kanë përkufizuar numrin e transmetuesve të hadithit mutevatir.

- Disa kanë thënë se minimumi duhet të jetë pesë, sepse pesë është numri i elitës së pejgamberëve (Nuhu, Ibrahim, Musa, Isa dhe Muhamedi a.s).

- Disa kanë thënë shtatë, sepse shtatë është numri i strehuesve në shpellë.

- Disa kanë thënë dhjetë, sepse më pak se dhjetë është shumësi i pakicës, e jo shumësi i shumicës.

- Disa kanë thënë njëzet, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***“Nëse nga ju janë njëzet durimtarë”***.

- Disa kanë thënë katërdhjetë, sepse ky është numri i llogaritur për namazin e xhumasë.

- Disa kanë thënë shtatëdhjetë, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***“Musa i zgjodhi katërdhjetë njerëz prej popullit të tij”***.

- Disa kanë thënë njëqind e pesëmbëdhjetë, sepse ky ka qenë numri i besatues i Ridvanit.

Të gjitha këto janë argumente të dobëta, të cilat nuk kanë as bazë logjike, e as tekstuale. Përpos kësaj, kjo nuk është problematika e mospajtimit, sepse mendimi më i preferuar nga të gjithë është: Hadithi mutevatir është ajo çka është e saktë prej lajmëruesve, pa u caktuar numri i transmetuesve saktësisht.⁴⁷

E dyta: Suneti meshhur.

Në esencë është lajm i vetmuar (në fillim), pastaj në shekullin (gjeneratën) e dytë është përhapur ai lajm (hadith) dhe është bërë hadith i transmetuar nga një grup i vogël njerëzish, që nuk mund të paramendohet se ata janë pajtuar që të gjithë për përgënjeshtim. Pas tre shekujve më nuk shikohet se a është përhapur, apo jo, sepse në përgjithësi të gjitha lajmet (hadithet) e vetmuara janë përhapur në këto (pas këtyre) shekujve. *Shembull:* Çka e transmeton një sehabij, apo dy sehabij, hadithin nga Pejgamberi s.a.v.s., e pastaj prej tyre e transmeton një numër i madh i njëpasnjëshëm.⁴⁸ *Shembull:* “**Nuk ka dyshim se veprat (shpërblehen) sipas qëllimit**”.

Pastaj hadithi: “**Islami është i ndërtuar në pesë shtylla**”.

Pastaj: “**Mos të dëmtojë askush dhe të mos dëmtohet askush**”.

Pastaj: **hadithi i mes-hit: mbi meste. E, po ashtu, hadithi i gurëzimit.**⁴⁹

Shihet qartë se dallimi në mes të hadithit mutevatir dhe hadithit meshhurë është se hadithi mutevatir është ai çka ka arritur numrin në fillim dhe gjatë tri gjeneratave të para. Ndërsa, hadithit meshhur në tri gjeneratat e para kjo i mungon. Për këtë arsye, Hanefijtë thonë: Hadithi meshhurë është hadith i sigurt në aspekt formal, e jo kuptimor.

Dispozita e sunetit meshhurë. Është e sigurt prejardhja prej sehaveve, të cilët e kanë transmetuar, por nuk është i sigurt se ka prejardhje prej Pejgamberit s.a.v.s..

Ky hadith në një anë tregon siguri të transmetimit, por edhe paragjykim të dyshimit se nuk është i sigurt. Për këtë arsye, ai që nuk e pranon, është mëkatar, e jo pabesimtar.

Ky lloj hadithi specifikon përgjithësimin e Kur'anit, siç është te Hanefijtë, dhe dispozita e tij është si dispozita e sunetit mutevatir.⁵⁰

Te Hanefijtë kjo i përngjanë parimit shtesë të librit të Allahut.

E treta: Suneti i vetmuar.

Është hadith të cilën e ka transmetuar vetëm një transmetues dhe nuk e ka arritur shkallën e nivelit të numrit të madh, si f.v. e kanë transmetuar një ose dy, por pa e arritur numrin e madh në tri gjeneratat e para. Shumë hadithe janë vërtetuar në këtë mënyrë.

Dispozita e hadithit të vetmuar. –Është i dyshimtë dhe nuk është i sigurt. Vaxhib është të vepruarit me të, por jo për të besuar se është vaxhib, sepse dyshimi ekziston në vërtetimin e tij. Këtë mendim e kanë shumica e dijetarëve dhe në përgjithësi fukahatë.⁵¹ Këtë mendim e ka zgjedhur Amediju, i cili ka thënë: “Hadithi i vetmuar është i sigurt, nëse nuk ka argumente kundërshtuese”.⁵²

Me përjashtim të disa dijetarëve, shumica absolute e tyre thonë se hadithi i vetmuar është i pranuar në kushte të caktuara. Të këtij mendimi janë edhe Hanefijtë.

3.Argumenti i sunetit

Dijetarët janë argumentuar se suneti i Pejgamberit s.a.v.s. është argument në nxerrjen e ligjeve të sheriatit, me argumente prej Kur'anit, ixhmait dhe argumenteve logjike.⁵³ I pari i është përmbajtur këtij argumentimi përpos ixhmait (ndihmues, mbrojtës dhe përmbajtës i hadithit) Imami Shafiju r.a. në librin e tij *“Umë”* dhe *“Risaletun”*

1. Kur’ani. –Allahu ua ka bërë obligim besimtarëve që të dëgjojnë dhe të pasojnë Pejgamberin s.a.v.s. E ka bërë dëgjueshmërinë e të Dërguarit të Tij dëgjueshmëri të Tij. I ka udhëzuar besimtarët që kur të kundërshtohen në mes vete, le të kthehen (bazohen) te Allahu dhe te i Dërguari i Tij. Dhe, nuk ka lejuar që askush të zgjedhë gjykim tjetër përpos gjykimit të Allahut dhe të Dërguarit. E ka bërë domosdoshmëri besimin në të Dërguarin. Kush e ka vaxhib që të dëgjojë dikë, ai e ka vaxhib t’i dëgjojë fjalët e tij. E, kush e ka vaxhib të besojë dikë, ai e ka vaxhib të pasojë fjalët e tij, veprat e tij dhe çdo vendim të tij.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:”

“O ju besimtarë, bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni me ndonjë gjë, drjejtouni Allahut dhe të Dërguarit; nëse besoni Allahun dhe ditën e kiametit, kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur”.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Kush dëgjon të dërguarin, ai veç ka dëgjuar Allahun”

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ata që janë të dëgjueshëm ndaj Allahut dhe të dërguarit, do të jenë në shoqëri me ata të cilët i ka bekuar Allahu: pejgamberët, të drejtët, dëshmorët dhe me njerëzit e mirë. Sa shokë të mirë do të jenë ata.” (Nisa, 69)

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Kur Allahu dhe i dërguari i tij caktojnë diçka, atëherë as besimtari, as besimtarja nuk kanë të drejtë të sillen sipas mënyrës së vet dhe kush nuk e dëgjon Allahun dhe të dërguarin e tij, ai me siguri ka humbur keq”. (El Ahzab; 36)

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe jo, pasha Zotin tënd, ata nuk të besojnë deri sa për gjykatës në mosmarrëveshjen e tyre nuk të pranojnë ty, e pastaj për shkak të gjykimit tënd nuk ndiejnë në shpirtërat e tyre aspak seriozitet, apo vështëresi, dhe përderisa nuk përulen tërësisht”, (Nisa, 65)

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Çka ju jep i dërguari, pranojeni, e çka ju ndalon, ndalojeni”.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Thuaj: nëse e doni Allahun, më pasoni mua, Allahu ju donë”.
(Ali Imran, 31)

“Le të ruhen ata, të cilët veprojnë në kundërshtim me urdhrin e tij, mos t’i kaplojë ndonjë sprovë, apo mos t’i godasë ndonjë dënim i dhembëshëm.” (En Nur, 63)

Duke kërkuar që të besohet në Pejgamber, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Me të vërtetë besimtarë janë vetëm ata të cilët besojnë Allahun dhe të dërguarin e tij dhe kur janë me atë për ndonjë çështje të përbashkët, nuk largohen pa marrë pëlqimin e tij”.
(En Nur, 24)

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe besoni Allahun dhe të dërguarin e tij, i cili beson në Allahun dhe në fjalët e Tij dhe besoni atë me shpresë se do të shpëtoni”. (El – Earaf)

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ai është i Cili dërgoi te populli analfabet peygamber prej mesit të tyre që t’u lexojë atyre ajetet e Tij, t’i pastrojë ata dhe t’ua mësojë Librin dhe urtësinë, edhe pse më herët kanë qenë në humbje të sigurt”. (El –Bekare)

Peygamberi s.a.v.s. i ka mbështetur të gjitha këto kuptime të ajeteve. Në haxhin lamtumirës ka thënë: *“Në mes jush kam lënë dy çështje: nëse i përmbaheni atyre, kurrë nuk do të humbni, e ato janë Libri i Allahut dhe sunetet e të dërguarit të Tij”*.⁵⁴

Mikdam bin Muad Jakrib transmeton se Peygamberi s.a.v.s. ka thënë: *“Pra, më është dhënë mua Kur’ani dhe ngjashëm me të. Përmbajuni Kuranit: çka të jetë e ndaluar në të, ndalohuni, çka të jetë e lejuar në të, lejoni; pra, çka të ndalon i dërguari i Allahut, sikur të ketë ndaluar Allahu*.⁵⁵

2. Ixhmai i Sehabeve Zoti qoftë i kënaqur me ata të cilët kanë bërë obligim pasimin e sunetit gjatë jetës dhe pas vdekjes së Peygamberit s.a.v.s.. Gjatë jetës së tij zbatonin gjykimet e tij, kryenin urdhrat e tij, largoheshin nga ndalesat e tij dhe nuk bënë dallim në mes të gjykimit të Kur’anit dhe gjykimit të Peygamberit s.a.v.s., ashtu siç u sqarua më parë te hadithi i Muadh bin Xhebelit: Kur e ka pyetur Peygamberi s.a.v.s.: **Po nëse nuk e sheh në librin e Allahut.** Ai iu është përgjigjur: **Atëherë gjykoj me sunetin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s..**

Praktika e Ebu Bekri Sidikit, Omerit dhe të tjerëve, të cilët gjithmonë kur nuk e gjenin zgjidhjen e gjykimit në Kur’an, vepronin me atë çka kishin dëgjuar dhe mësuar prej Peygamberi s.a.v.s., ose çka kishin dëgjuar sehabet prej Peygamberit s.a.v.s. .

Pas sehabeve kështu kanë vepruar dijetarët islamë dhe askush nuk e ka refuzuar, por të gjithë e kanë pranuar.

3.Argument logjik. –Allahu i Lartmadhëruar e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij ta pasojë shpalljen dhe ta përcjellë shpalljen e Tij.

Transmetimi i shpalljes është leximi i Kur'anit, ndërsa sqarimin e ka bërë Pejgamberi s.a.v.s.

Janë të fuqishme argumentimet për sigurinë e Pejgamberit s.a.v.s. që të mëkatojë, të harrojë apo të bëjë gabim. Për këtë sheriati është Kur'ani dhe fjalët e Pejgamberit s.a.v.s.⁵⁶

Përpos kësaj, në të shumtën e rasteve Kur'ani ka nevojë për sqarimin e të pasqaruarës, përkufizimin e të papërkufizuarës, specifikimin e të përgjithshmes.

Shembull:

“Falen i namazin dhe jepen i zekatin” .

“Është bërë obligim agjërimi për ju”.

“Kryerja e haxhit në shtëpinë e shenjtë për njerëzit është obligim për Allah”.

“Allahu e ka lejuar shitblerjen dhe e ka ndaluar kamatën” .

“Dhe ju është lejuar juve, përpos këtyre për ju”.

“Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart e tyre”, e ajete të ngjashme të cilat kanë nevojë për sqarim. E këtë detyrë e kanë kryer fjalët dhe veprat e Pejgamberit s.a.v.s. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Ne e kemi zbritur Kur'anin që t'ua sqarosh njerëzve çka u ka zbritur atyre”.**

Xhibrili a.s. ia zbriste sunetin Pejgamberit s.a.v.s. ashtu siç ia zbriste Kur'anin. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe nuk flet nga vetvetja, por në të vërtetë është shpallje, e cila i shpallet atij”.**

Po mos të kishte qenë suneti argument për muslimanët, nuk do të kishte pasur mundësi zbatimi i farzeve të Kur'anit dhe as zbatimi i dispozitave të tij.

Evzaiju ka thënë: **“Më shumë nevojë ka libri (Kur'ani) për sunetin se sa suneti për librin (Kur'anin)”.**

Ibn Abdul Berri ka thënë: **“Suneti sqaron dhe definon çështjet përfundimtare të Kur’anit”**.

Zenadikët dhe disa të vetmuar të Havarixhëve e refuzojnë argumentimin e sunetit. Abdurrahman bin Mahdi thotë: Zenadikët dhe Havarixhët kanë shpikur hadithin: Çka u tregohet prej fjalëve të mia, krahasoni me librin e Allahut: nëse është në përputhshmëri me Kur’anin, atëherë atë unë e kamë thënë, po nëse është në kundërshtim me Kur’anin, unë nuk e kam thënë, po si të kundërshtoj librin e Allahut(një formulim tjetër), kurse ai më ka zbritur mua për ju”.

Jahja bin Muijni ka thënë: Është hadith i shpikur, e kanë shpikur Zenadikët. Imam Shafiiu ka thënë: **“Nuk ka transmetues as të vogël, as të madh që ka transmetuar e që vërteton besueshmërinë e këtij hadithi.”**⁵⁷

Argumentet e mohuesve të argumentit të sunetit

Këta mohues janë mbështetur në mospranimin e sunetit me disa ajete të kuptimit sipërfaqësor:⁵⁸

1. Ata thonë: Kur’ani është sqarim për çdo gjë. Është në gjuhën arabe dhe nuk ka nevojë të sqarohet në gjuhën joarabe. Hadithet që i transmetojnë transmetuesit janë njerëz, të cilët është e pamundur të mos rrejnjë, të mos gabojnë apo të mos harrojnë. Suneti nuk mund të ngritet në vendin e librit i cili është argument i prerë. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Ne nuk kemi lënë asgjë mangut në libër (Kur’an)”**. Ata thonë: Po të kishte pasur nevojë Kur’ani për sunet, atëherë do të ishte i mangët dhe i paqartë. E, kjo do të tregonte kundërshtim me fjalën e Allahut të Lartmadhëruar, e cila gjë është absolutisht e pamundur.

I kundërpërgjigjemi këtyre se kontesti i ajetit:” **Nuk ka asnjë gjallesë në tokë, qoftë shpend, i cili fluturon me dy krahët e tij, e që nuk janë popull sikurse ju, dhe Ne nuk kemi lënë asgjë mangut në libër”**. Tregon se fjala **“libër”** ka për qëllim çështje tjetër, sepse Zoti i

Lartmadhëruar nuk ka lënë mangut në asnjë çështje prej çështjeve të të gjitha umeteve, edhe pse ata kanë bërë llogaritje të panumërta, kanë shkruar pandërprerë dhe kanë pasur dituri, sepse dituria e Allahut përfshin çdo gjë.

Por, edhe nëse dakordohemi se qëllimi i fjalës “**libër**” është për Kur’anin, atëherë nuk është qëllimi për të gjitha gjërat në tërësi, sepse shumë çështje të kësaj bote nuk janë përmendur në Kur’an. Qëllimi i fjalës “**asgjë mangut**” është për ligjet fetare, të cilat janë bazë e akaidit (besimit) si obligueshmëri e zekatit, të lejuarit e të mirave, të ndaluarit e të këqijave, e që sqarimin e tyre e ka marrë përsipër argumentimi tjetër, siç është fjala e Zotit të Lartmadhëruar “**Dëgjoni Allahun dhe dëgjoni të dërguarin**”.

Kështu interpretohet edhe fjala e Zotit të Lartmadhëruar “**Dhe ne ta kemi zbritur librin, sqarim për çdo gjë**”. Nuk është për qëllim gjithëpërfshirja. Edhe ky ajet komentohet si ajeti i sipërpërmendur. Këtë e tregon edhe Ibni Mes’udi r.a. kur ka thënë: **Allahu ka mallkuar heqësen e qimeve të vetullave dhe atë që i heq.**⁵⁹

Këtë e dëgjon një grua e fisit Esed, e cila shkon të Ibni Mes’udi dhe i thotë: O baba i Abdurrahmanit, kam dëgjuar se e ka mallkuar këtë e këtë.

Ibni Mes’udi i thotë: Po pse të mos e mallkojë atë që e ka mallkuar i Dërguari i Allahut dhe që është në librin e Allahut.

Ajo i thotë: E kam lexuar tërë mus’hafin, po nuk e pashë atë që ti thua. I thotë: Po ta kishe lexuar, do të kishe hasur në ajetin Kur’anor: “**Çka ju jep (urdhëron) i dërguari, merreni atë, dhe çka ju ndalon juve për diçka, largohuni**”.

Transmetohet se Shafiiu a.s. ka qenë ulur në mesxhidi haram, duke iu folur njerëzve, dhe u thotë: Për çdo gjë që më pyetni ju jap përgjigjen, duke u bazuar në librin e Allahut. Një njeri e pyet për disa kafshë dëmtuese që lejohen të mbyten në Qabe. Po ku e more këtë dispozitë në Kur’an. I përgjigjet: “**Çka ju jep (urdhëron) i dërguari, merreni atë, dhe çka ju ndalon juve për diçka, largohuni**”. Pastaj, e tregon hadithin nga Omeri r.a.

Së dyti, ata kanë thënë: Suneti nuk është argument, nga shkak se Allahu nuk e ka bërë detyrim të ruhet, ashtu siç e ka bërë ruajtjen e Kur'anit. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***“Vërtet, Ne e kemi zbritur Dhikrin (Kur'anin) dhe ne e ruajmë atë”***. Ky ajet është posaçërisht për Kur'anin, pasi që drejtimi është vetëm për të.

I kundërpërgjigjemi në dy aspekte:

E para: Dhikr nuk është qëllimi posaçërisht vetëm për Kur'anin, por përkundrazi i afrohet alternativës se qëllimi është për sheriatin, i cili përfshin Kur'anin dhe sunetin, sikurse është kuptimi i fjalës së Zotit të Lartmadhëruar; ***“Dhe nuk lejon Allahu që të shuhet, por e plotëson (dhe e forcon) dritën e tij, edhe nëse e urrejnë pabesimtarët”***

Drita e tij është sheriatu dhe feja e Tij.

E dyta: Edhe nëse dakordohemi se fjala ***“Dhikr”*** ka për qëllim posaçërisht Kur'anin. Nuk është ajeti argumentimi, siç thonë ata se suneti nuk është argument, sepse përkufizimi nuk është joalegorik; sepse Allahu ka ruajtur edhe gjëra të tjera përpos Kur'anit. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***“Vërtet, Allahu i mban qiejt dhe tokën që të mos biejnë (humbin)”***. Kjo është, sepse i ruan. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***“Allahu të mbron (ty o Muhamed) nga njerëzit, të ruan ty”***.

Përfundim: Mospranimi i argumenti të sunetit sjell çështje të rrezikshme në fe, sepse, nëse nuk argumentohemi me të, nuk mund të kuptojmë namazin, zekatin, haxhin e farzet tjera në përgjithësi të Kur'anit, të cilat i ka marrë përsipër Kur'ani t'i sqarojë, përpos në aspekt gjuhësor. Kështu bien nga obligimi namazet, zekati të cilat janë përcjellur besnikërisht deri tek ne, obligimet e tyre. Kështu ka thënë Imam Shafiiu r.a. Kështu ka thënë edhe dijetari Shefkaniju në librin ***“Irshadul Fuhul”***.

Ibn Bedrani ka thënë: Çdokush që ka dituri e di se argumentimi me sunetin e pastër dhe pavarësia e tij në sheriatin islam është domosdoshmëri fetare dhe këtë nuk ka kundërshtuar askush, përpos atyre që nuk kanë njohuri në fenë islame.⁶⁰

Vendi i sunetit në krahasim me Kur'anin

Si argument suneti e zë vendin e dytë, menjëherë pas Kur'anit. Është burim i dytë prej burimeve të sheriatit, sepse Kur'ani është argument i prerë dhe i sigurt, ndërsa suneti është jo i prerë dhe i pasigurt. Pa dyshim se e sigurt është sqaruesi i Kur'anit, e sqaruesi pason të sqaruarën. E sqaruara ka përparësi të jetë e para. Kjo vërtetohet nga transmetime të shumta, e një prej tyre është hadithi i Muadh bin Xhebelit: **E, me çka do të gjykosh, o Muadh?**, të cilin hadith e kemi treguar më herët.

Pastaj, praktika e Ebu Bekri Sidikit në ixhtihadin e tij, letra e Omerit r.a., kur ia dërgon kadiut Sherif, ku i thotë: Shiko çka është e qartë për ty në librin e Allahut dhe mos pyet askë tjetër. Po nëse nuk e sheh në librin e Allahut paso sunetin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Ibn Mes'ud r.a. ka thënë: Atij të cilit i paraqitet rasti të gjykojë, le të gjykojë me atë çka është në librin e Allahut. Po nëse paraqitet diçka çka nuk është në librin e Allahut, le të gjykojë ashtu siç ka gjykuar Pejgamberi s.a.v.s..

Ndërsa, sa i përket sunetit, nga aspekti i përcaktimit të dispozitave, në librin **“Risale”** Imam Shafiiu r.a. ka sqaruar kështu:⁶¹

Suneti ose mund të jetë sunet i fortë, i cili sunet vërteton dispozitën Kur'anore,

ose sunet sqarues i Kur'anit,

ose për të argumentuar me të shfuqizimin e një dispozite të Kur'anit, për të cilën Kur'ani ka heshtur.

Këto katër forma nevojiten të sqarohen në detaje:

E para: Që suneti të vërtetojë një dispozitë, e cila është në Kur'an. Kështu dispozita ka dy burime. *Shembull:* Urdhri për faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin e ramazanit, kryerjen e haxhit, pastaj ndalimin e idhujtarisë, dëshmimi i rrejshëm, sjelljen e keqe ndaj prindërve, vrasjen e njeriut pa të drejtë, ndalesën e marrjes së pasurisë të tjerëve pa të drejtë. *Shembull: Nuk lejohet asgjë për muslimanin,*

përpos ajo çka është e pastër për veten e tij.⁶² Ky hadith është vërtetues i fjalës së Allahut të Lartmadhëruar: ***“O ju që keni besuar, mos hani pasurinë e njëri-tjetrit me padrejtësi”***.

Mirësia ndaj grave.

Shembull: Hadithi: ***“Frikësojuni Allahut dhe silluni mirë ndaj grave”***.⁶³ Ky hadith është në përputhshmëri me fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: ***“Dhe jetoni me to me mirësi***

E dyta: Që suneti të jetë sqarues i Kur’anit. Këtu do t’i përmendim tri mënyra të sqarimit.

a. – Që Kur’ani të sqarojë atë që Kur’ani e thotë globalisht.
Shembull: Hadithet të cilat sqarojnë mënyrën e faljes së namazit, e përqindjes së zekatit, mënyrën e kryerjes së haxhit, shitblerjen e vlefshme dhe të pavlefshme, llojet e kamatës, perin e bardhë dhe perin e zi te ajeti i agjërimit.

b. – Që Kur’ani të specifikojë përgjithësimin e Kur’anit.
Shembull: Hadithi i Pejgamberit s.a.v.s.: ***“Nuk lejohet njeriu të martohet as me hallën, as me tezën, as me vajzën e vëllait, as me vajzën e motrës”***.⁶⁴ Ky është specifikim i fjalës gjenerale të Zotit të Lartmadhëruar: ***“Dhe ju është lejuar juve, përpos këtyre”***.

Shembull: Hadithi i Pejgamberit s.a.v.s. ***“Ka ndaluar çdo egërsirë mishngrënëse (shqyese) dhe çdo shpend kthettrashqyes”***.⁶⁵ Ky hadith ka qenë specifikim i asaj se arabët ushqeheshin me ato shpendë dhe kafshë, me ajetin : ***“Thuaj: prej asaj që më është shpallur nuk shoh asgjë të ndaluar prej ushqimeve, me të cilat ushqeheni, përpos nëse është coftëtinë ose gjak rrjedhës, ose mish derri, sepse këto janë fëlliqësirë ose mëkat, sepse janë thrurur jo në emër të Allahut.”***

Shembull: hadithi: ***“Vrasësi nuk trashëgon asgjë”***,⁶⁶ është specifikuar prej ajeteve të trashëgimisë në suretu Nisaë. Zoti i

Lartmadhëruar thotë: ***“Ju porosit Allahu qëpër fëmijët tuaj mashkullit i takon sa dy femrave”.***

c. – Që suneti të përcaktojë të papërcaktuarën e Kur’anit, ose të shpjegojë qëllimin e Kur’anit, kur Kur’ani e tregon diçka të paqartë. *Shembull:* Hadithi ka përcaktuar vendin e prerjes së dorës, e ai vend është kyçi i shuplakës së dorës.⁶⁷ Ky është përcaktim i papërcaktimit të ajetit: ***“Vjedhësit dhe vjedhëses prejuani duart e tyre”.***

Shembull: përsëritja e pastrimit të pjesëve të abdestit dhe obligueshmëria e pastrimit të bërrylave. Është sqarim i ajetit: ***“Pastroni fytyrat tuaja dhe duart deri në bërryla”.***⁶⁸ Në këtë ajet është e mundur të përsëritet, por edhe të mos përsëritet pastrimi i pjesëve; po ashtu, mund të pastrosh edhe të mos pastrosh bërrylat. Por, hadithi i ka sqaruar gjërat e paqarta.

E treta: - Që suneti të tregojë të shfuqizuarën dhe shfuqizuesin e Kur’anit. Medhhebi Shafii nuk e lejon që Kur’ani të shfuqizohet me sunet, duke u bazuar në ajetin: ***“Ne nuk shfuqizojmë ndonjë ajet, apo të harrojmë atë, e që Ne të mos sjellim më të mirë se ajo, apo të ngjashëm me atë”***, sepse folja ***“Ne sjellim”*** tregon se Ai i cili sjell të ngjashëm, apo më të mirë, është Allahu i Lartmadhëruar. E, kjo ndodh vetëm atëherë kur shfuqizues është Kur’ani, ndërsa dy fjalët ***“më të mirë se ajo, apo të ngjashëm”*** tregon që zëvendësuesi të jetë më i mirë se e zëvendësuarja ose së paku i ngjashëm me të. E, suneti nuk është kështu. Por, suneti është ai që sqaron shfuqizimin e Kur’anit me Kur’an.

Shembull i kësaj është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Juve ju është bërë obligim ajo se kur ndonjërit prej jush i vjen vdekja, le të lërë testament për prindërit dhe të afërmit, është obligim i të devotëshmeve që ta përcjellin me drejtësi”. El Bekare,180

Ky ajet është shfuqizuar me ajetet e trashëgimisë, mirëpo njohja e këtij shfuqizimi është bërë nëpërmjet sunetit.

Mendimin e Shafiiut e ka kundërshtuar mendimi i shumicës absolute të dijetarëve, e po ashtu edhe Bejdeviju dhe Esneviju nga vetë dijetarët e medhhebit Shaffij. **Ata thonë:** Se suneti ndonjëherë shfuqizon Kur’anin. E kanë ilustruar me shembullin: ***“Për trashëgimtarët nuk ka***

testament".⁶⁹ Ajetin të cilin e kemi cekur më herët: **"Ju kemi bërë obligim kur ndonjërit i vjen vdekja"** nuk është shfuqizuar ajeti i trashëgimisë, sepse ky ajet nuk bie ndesh me ajetin e testamentit për të afërmit; sepse, e para, është për një të tretën e pasurisë, ndërsa testamenti zbatohet me një të tretën. Do ta sqarojmë më detajisht në temën e shfuqizimit.

E katërta: -Që suneti të jetë vendosës dhe vërtetues i dispozitës për të cilën ka heshtur Kur'an, e që ajo dispozitë të jetë vendosur drejtpërsëdrejti prej sunetit, e për atë dispozitë nuk ka tekst Kur'anor. *Shembull:* Hadithet që tregojnë për gurëzimin e prostitutit të martuar,

- dispozita e përbetimit dhe një dëshmitari.
- Të ndaluarit e mëndafshit dhe zbukurimit me ari për meshkuj.
- Sadekatul fitri.
- Obligueshmëria e **"dijes"** dhe **"Akiles"**.
- Të ndaluarit e mishit të gomarit,
- lirimi i robit e të ngjashme.

Vërehet se Shafiiu e ka pranuar që suneti është për të shtuar në Kur'an, suneti është përcjellës i Kur'anit dhe se suneti kthehet në të; është brenda kornizave të bazave të përgjithshme të dispozituar në Kur'an. Ixhtihadi i Pejgamberit s.a.v.s. është në dispozitat bazore në Kur'an dhe në thelbin legjislativ. Atëherë, nuk mund të ndodhë mospajtim në mes të dispozitave Kur'anore dhe të sunetit

5. Medhhebet e sehabëve dhe dijetarëve rreth të vepruarit me hadithin e vetmuar dhe argumentimi me të

E para: -Siç kemi cekur më parë, sehabet janë pajtuar se lejohet të veprohet me hadithin e vetmuar. Hadithi i vetmuar është hadithi, të cilin e kanë transmetuar një ose dy, pa arritur në shkallën e shumësit të madh, e as të vogël. Sehabet me kësi hadithi kanë vepruar aq shumë, sa që rastet janë të panumërta. Prej atyre rasteve janë: pranimi i hadithit të Ebu Bekri

Sidikit në ditën Sekif, kur iu është drejtuar popullit Kurejsh.⁷⁰ Hadithi i tij: ***“Pejgamberët varrosen aty ku vdesin”***.

Po ashtu hadithi: ***“Ne pejgamberët nuk trashëgohejmë; atë që e lëmë mbetet (jepet) sadaka”***.⁷¹

Kanë vepruar me hadithin e Mugirete bin Shuëbes dhe Muahmed bin Muslemes se ***Pejgamberi s.a.v.s. ia ka dhënë gjyshe një të gjashtën***.⁷²

- Omeri r.a ka vepruar me hadithin e Amr bin Hazmit në ***“Dije”***.

Po ashtu, Omeri r.a me hadithin e Abdurrahman bin Aufit në pranimin e xhizjes prej zjarrputistëve: ***“Veproni me to, siç veproni me pasuesit e librit”***.⁷⁴

- Othmani r.a. ka vepruar me hadithin e Ferias bin Malikut për vendin e qëndrimit të gruas në periudhën e Idetit pas vdekjes së burrit të saj. E, ai hadith është: ***“Qëndro (në shtëpi të burrit) deri sa të përfundojë ideti”***.⁷⁵ (në shtëpinë e burrit).

- Ibn Abasi ka vepruar me hadithin e Ebi Seid el Hudrijit për kamatën në të holla, pasi që para kësaj nuk gjykonte për kamatizim në ***“NESIE”(mallra me malëra shtesë)***.⁷⁶

- Shumica absolute e dijetarëve kanë gjykuar me hadithin e Aishes r.a. ***për obligueshmërinë e Guslit, kur të takohen dy organet seksuale***.⁷⁷

Përpos rasteve të sipërpërmendura, ka edhe shumë raste të tjera.⁷⁸

Vetëm se sehabet dallohen në rrugën e vërtetësimit të sunetit me hadithe të vetmuar dhe asaj çka transmetohet, vetëm e vetëm për ta bërë më të fuqishme, sa më bindëse, sa më të besueshme vërtetësinë e hadithit nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s.

Ebu Bekri Sidiki dhe Omeri r.a. nuk pranonin hadithin e vetëm, përpos me dëshminë e dy vetëve (sehabeve), të cilët e kanë dëgjuar hadithin prej Pejgamberit s.a.v.s.

Shembull: Ngjarjen e trashëgimisë së gjyshes, të cilën e cekëm më parë. Ajo (gjyshja) shkon te Ebu Bekri Sidiki dhe e kërkon të drejtën e saj trashëgimore.

Ebu Bekri i thotë asaj: Nuk shoh se ke të drejtë, sipas Kur'anit, dhe nuk di se Pejgamberi s.a.v.s. ka treguar se të takon ty pjesë trashëgimie. Pastaj, pyet njerëzit.

Ngritet Mugirete bin Shuëbe dhe thotë: Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. se asaj i takon një e gjashta.

Ebu Bekri i thotë: A ka ndonjë tjetër që e ka dëgjuar me ty.

Atëherë dëshmon Muhamed bin Muslemete për të njëjtën gjë dhe e zbaton.

Kështu ka vepruar edhe Omeri. Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Sejid el Hudriji, i cili ka thënë: Kam qenë ulur në një kuvend prej kuvendimeve të Ensarëve, aty i frikësuar hynë Ebu Musa el-Eshariju.

Në kuvend e pyesin: Pse je frikësuar?

Ai përgjigjet: Më ka urdhëruar Omeri që të shkoj tek ai. Shkova tek ai, kam kërkuar leje, por për shkak se nuk ka dëgjuar, nuk më është dhënë leje, jam kthyer.

Pas një kohe më ka pyetur: Pse nuk ke ardhur në kohë të caktuar.

I kam thënë: Unë kam ardhur, kam dhënë selam (kam kërkuar leje) tri herë. Pasi që nuk kam marrë përgjigje, jam kthyer, sepse Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***“Nëse ndonjëri nga ju kërkon leje tri herë dhe nuk i jepet leja, le të kthehet nga ka ardhur”***.⁷⁹

Omeri më ka thënë: Për këtë patjetër duhet të më sjellësh dëshmi, se e ka thënë kështu (Muhamedi a.s.).

Ata thanë: Dëshmi do të ketë prej ndonjërit prej neve?

Atëherë ngritet Ebu Saidi dhe dëshmon vërtetësinë.

Pastaj Omeri thotë: Unë nuk të kam akuzuar për asgjë, por çështja ishte se në pyetje ishte hadithi i Pejgamberis.a.v.s..

Aliu r.a. kërkonte nga transmetuesi i hadithit që të përbetohet se ai e ka dëgjuar hadithin nga Pejgamberi s.a.v.s.. Ai ka thënë: Kur kam dëgjuar ndonjë hadith nga Pejgamberi s.a.v.s., ka pasur dobi sa ka dashur Allahu. Kur dikush më ka treguar ndonjë hadith, e kam detyruar të përbetohet, e pasi që është përbetuar, i kam besuar.

Ndonjëherë sahabiju e ka kthyer prapë hadithin ose për shkak të mosbesimit të transmetuesit, ose e ka ditur se ai hadith është shfuqizuar, ose për shkak se ka pasur hadith më të fuqishëm se ai, sipas mendimit të tij. Këtë do ta sqarojmë me shembuj praktik.

Omeri r.a. nuk e ka pranuar hadithin e Fatimes bin Kajsit, kur ka kërkuar vendbanim.

Ajo ka thënë: Burri im më ka lëshuar, e nuk më ka lënë mua i Dërguari i Allahut vendbanim dhe as furnizim.⁸⁰

Omeri i përgjigjet asaj: Nuk e kemi lënë anash librin e Zotit tonë, e as të pejgamberit tonë, për shkak të një gruaje, për të cilën nuk dimë a gënjen apo flet të vërtetën, a e ka mbajtur përmendësh (hadithin), apo e ka harruar.

Ajshja r.a. nuk e ka pranuar hadithin e Ibni Omerit: **I vdekuri dënohet për shkak të vajtimit të familjes së tij**,⁸¹ sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Nuk e bart barrën e tjetrit askush”**, që do të thotë se njeriu nuk dënohet për shkak të mëkatit të tjetrit.

Ibn Abasi nuk e ka pranuar hadithin e Ebu Hurejres: **Kush e bart xhenazen, le të marrë abdest**. Ai(Ibn Abasi) ka thënë: Bartja e xhenazes nuk na obligon abdesin.

Aliu r.a. nuk e ka pranuar hadithin e Muakal bin Senanit el Eshxhaijut, kur i thotë Ibn Mes’udit: Ka gjykuar në dispozitiv për kompensim, nëse gruas i vdes burri para se të kontaktojë seksualisht, që ajo të marrë mehrin, sepse asaj i takon mehr i ngjashëm me një grua paralele as më shumë, e as më pak. Kam gjykuar, sepse kështu ai ka thënë, se kështu ka gjykuar Pejgamberi s.a.v.s. me rastin e Birua bint Vashik el Eshxhaije. Ibn Mes’udi është gëzuar për së tepërmi kur e sheh se ngjashëm ka gjykuar Pejgamberi s.a.v.s.⁸²

Mirëpo, Aliu r.a. nuk ka vepruar me këtë hadith dhe nuk ka paraparë që asaj t'i takojë mehri. Ai ka thënë: Ne nuk e lëmë librin e Allahut për shkak të thënies së një beduini. Aliju r.a. ka kundërshtuar që t'i jepet diçka gruas, nëse burri i saj vdes para kontaktimit seksual. Ai i ka i dhënë përparësi Krijuesit ndaj hadithit të vetmuar, i cili nuk është i vërtetë, sipas mendimit të tij.

Ky mospranim dhe ky qëndrim i sehaveve nuk është se me sunet nuk argumentohet, por nuk e kanë pranuar dhe kanë marrë qëndrim, për shkak se ka munguar ndonjë kusht, ose ka pasur argument përballë sunetit, ose për shkak se çështja e ka kërkuar të jetë ashtu.

E dyta: Argumentimi me hadithin e vetmuar. Atyre të cilët duke argumentuar se është argumenti i dyshimtë, është e mundur që të ketë në të mashtime dhe rrena prej transmetuesve, dhe për shkak se me të ka shumë që kanë thënë me hamendje, sipas dëshirave, e që është vështirë se mund të dallohet e vërteta prej të pavërtetës.

Në lidhje me këtë çështje është përgjigjur Shafiiu. Argumentimet e tij do t'i reduktojmë në pesë pika:

E para: Në shariat Kijasi është i vërtetuar me Kur'an ose me sunet. E, kjo do të thotë se gjykimi bëhet me dëshminë e dy dëshmitarëve, ose dëshmia e një burri dhe një gruaje; aty nuk e lejon etika të hyjnë meshkujt. Gjykimi: Domosdoshmëria e dhënies përparësi anës së vërtetë ndaj të pavërtetës.

E dyta: Pejgamberi s.a.v.s. ka apeluar që të ruhet fjala e tij, veprat e tij dhe veprimi me to, pa marrë parasysh në mënyrë individuale apo kolektive. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *"Zoti e bekoftë robin, i cili dëgjon thënien time, e mëson përmendësh, e ruan dhe e përcjell. Ndoshta përcjellës i fikhut është ai i cili nuk është dijetar. Ndoshta bartësi i fikhut është më i vlefshëm se fekihi, i cili është më i mirë se ai vet. Tri gjëra nuk e mashtojnë zemrën e muslimanit: sinqeritei i punës vetëm për Allah, këshilla për muslimanët dhe përmbajtja ndaj xhematit. Thirrja e tyre për fshin ata të cilët vijnë pas tyre."*⁸³Nuk ka

ndikim në përcjellje, vetëm nëse përcjellësi i fjalës është argument i cili pranohet prej pranuesit”.

E treta: Është vërtetuar se sehabet kanë përcjellur ligjet e sheriatit me hadith të vetmuar, ndërsa, Pejgamberi s.a.v.s. i ka aprovuar. Përpos kësaj Pejgamberit s.a.v.s. i ka mjaftuar që një transmetues t’ia përcjellë ligjin, siç ka qenë rasti me ngjarjen e kthimit të falësve në mesxhidin Kuba, ku një njeri ka lajmëruar për ndryshimin e kiblës dhe e ka ndryshuar.

E katërta: Pejgamberi s.a.v.s. ka dërguar në të njëjtën kohë dymbëdhjetë sehabë tek dymbëdhjetë mbretër për t’i thirrur në islam. Pejgamberi s.a.v.s. u dërgonte letra udhëheqësve nëpërmjet një njeriu.

E pesta: Sehabet kanë pranuar një lajm, nëse nuk kanë gjetur argument në Kur’an apo sunet, siç e përmendëm më parë. Ata kanë gjykuar për një çështje me mendimin e tyre; kur e kanë mësuar një hadith, e kanë kthye mendimin e tyre personal, ashtu siç ka vepruar Omeri, i cili kishte gjykuar që të trashëgohet **dija** e të vrarit për **“Akiletih**i”. Pastaj, e ka kthyer (ndryshuar) mendimin me hadithin e Dahak bin Sufjanit, ku thuhet : **“Gruaja trashëgon nga Dija e burrit të saj”**.

Këto argumentime i kanë vërtetuar shumica absolute e dijetarëve,⁸⁴ duke argumentuar me mendimin e tyre se është vaxhib të vepruarit me lajmin e vetmuar. E, pastaj kanë shtuar argumentime të tjera prej Kur’anit logjik:⁸⁵

Sa i përket Kur’anit, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe kur Allahu mori besatimin prej atyre të cilëve iu është dhënë libri që ta sqarojnë atë (Librin) dhe mos ta fshehin”**.

Zoti i Lartmadhëruar ka marrë besatim prej atyre të cilëve iu është dhënë libri që t’ua sqarojnë njerëzve dhe mos të fshehin asgjë prej tyre. Ky ka qenë sqarim për secilin prej tyre, sepse ligjërimi është për çdo njeri, aq sa ka mundësi. E, është e pamundur që të gjithë të kenë mundësi. Atëherë bëhet e qartë se ligjërimi është për çdonjërin, nga

shkaku se shumësi është për kolektivin, por që përfshin secilin veç e veç. Po mos të ishte lajmi i vetmuar argument, nuk do të kishte urdhëruar sqarimin kolektivit veç e veç. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **”Po mos të jetë një grup prej çdo grupi të tyre, të cilët specializohen në fe dhe që të këshillojnë popullin e tyre, nëse ata kthehen prapa, e që qëllimi i tyre është që t’ua tërheqin vërejtjen”**.

Dihet se skuadra është prej tre vetëve, ndërsa më pak se skuadra është miniskuada, ose prej një individi, ose prej dy individëve, ndërsa pjesa e ajetit që të tërheqin vërejtje, i cili mund të realizohet prej fjalës së një individi, apo dy vetëve. Po mos të ishte lajmi i vetmuar argument, nuk do të kishte qenë obligim që dëgjuesi ta përqëndrojë mendjen dhe që të kujdeset çka thotë tërheqëvërejtësi, i cili është në pjesën e ajetit **“me qëllim që të jeni të kujdesshëm (vëmendshëm)”**.

Është urdhër prej Zotit të Lartmadhëruar, që do të thotë është obligim vëmendësia.

Sa i përket anës logjike, lajmi mund të jetë i vërtetë dhe i pavërtetë, ndërsa vërtetësia për drejtësi është e kushtëzuar në transmetim tek i cili anon vërtetësia më shumë se gënjeshtër; e vetëm atëherë merret vendim që të vepruhet me lajmin e vetmuar në fetva, dëshmi, dhe në çështjet e dynjasë, si f.v. lajmi i mjekut se diçka të bën dëm e të ngjashme, si në mendimet në luftëra etj etj.

Mospranuesit me lajmin e vetmuar prej të cilëve janë: Xhebaniju, Kashaniju, një pjesë e mutekeliminëve, disa Revadij kanë sjellë disa argumente, të cilat çdo analizues i kupton se janë argumente të dobëta. Për këtë arsye, nuk e shoh të arsyeshme t’i përmend këtu, pasi që mjaftojnë argumentet e shumicës absolute të dijetarëve që i përmendëm më parë.

E treta: Medhhebi i dijetarëve të katër medhhebeve për veprimin me lajmin e vetmuar.

Hanefijtë për të vepruar me lajmin e vetmuar (personal) i kushtëzojnë tre kushte:⁸⁶

1. – **Që transmetimi të mos veprojë të kundërtën e asaj që e transmeton.** Nëse e kundërshton, atëherë veprohet me mendimin e tij, e jo me transmetimin e tij, sepse kundërshtimi i tij me veprim është për shkak të shfuqizimit të asaj thënie, pasi që e ka mësuar të kundërtën. Për këtë arsye, nuk kanë vepruar me lajmin e Ebu Hurejres, kur ka treguar hadithin për qenin: **Kur e lëpin qeni enën e ndonjërit prej jush, le ta lajë shtatë herë, njërën prej atyre shtatë herëve ta bëjë pastrimin me dhe.**⁸⁷ I ka mjaftuar Ebu Hurejres që ai vetë në vepër ta bëjë pastrimin tri herë, siç ka transmetuar Darukutniju.

2. – **Që tematika e hadithit të mos jetë temë që është e përhapur çdokund, e kanë nevojë njerëzit për sqarim.** Pra, çështja është që t'i plotësojë kërkesat për transmetimin e tij në mënyrë të shumënumërt dhe të njohur. Transmetimi i tij në një rrugë mund të lindë dyshimin në vërtetësinë e burimit nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Për këtë arsye, nuk kanë vepruar me hadithin e ngritjes së duarve në ruku në namaz.⁸⁸ Vërehet se Shafijitë e kanë vërtetuar këtë hadith prej shtatëdhjetë sehavebeve.

3. – **Që hadithi të mos jetë në kundërshtim me Kijasin dhe me bazat e sheriatit, nëse transmetuesi nuk është Fekijh,** sepse transmetimi i hadithit bëhet me kuptim të pranuar në mes të transmetuesve e jo tekstualisht. Mirëpo, nëse transmetuesi nuk është fekihë, është e mundur që t'i ikë diçka nga kuptimi, nga i cili kuptim do të ndërtohej ligji (dispozita). Nga transmetuesit, që nuk janë fukaha, janë: Ebu Hurejre, Selam Farisiju, Enes Bin Maliku. Për këtë arsye, nuk e kanë marrë parasysh në veprim hadithin e Ebu Hurerjes për delen apo Devën, e cila nuk është mjelur. Është hadithi i Pejgamberit s.a.v.s.: **Mos e lini delen apo lopën të pamjelur (për ta shitur). Kush e blen, ai ka të drejtë të zgjedhë në mes të dy çështjeve, pasi që ta mjelë: nëse dëshiron, e mban në pronësi, e nëse dëshiron, e kthen së bashku me një enë (saa) me hurme.**⁸⁹

Ata thonë: Ena (saa) me hurme është zëvendësim për qumështin e mjelur. E, kjo është në kundërshtim me Kijasin dhe rregullat e sheriatit. Është në kundërshtim me kompensimet e dënimit, ku rregull është: **“E ngjashmja me të ngjashmen dhe sasia e njëjtë me sasi të njëjtë”.** Po

ashtu, është në kundërshtim me rregullin **“EL haraxhu bid-Daman”**. (*Dëshmipërblimi për shkak të shfrytëzimit, nëse e kthen mallin*),⁹⁰ e cila e bën **“GILEN (kompenzimin)”** si rezultat, në vend të të njëjtit artikull atij të cilit duhet paguar dënimi. Kjo dëshmon se qumështi është i blerësit të deles apo deles, ndërsa çështja, për t’ia kthyer një enë (saa) me hurme, është në kundërshtim me këtë rregull.

E vërteta është se ky kusht është mendimi i Isa bin Ebanit dhe atyre që e pasojnë prej Hanefijve të mëvonshëm. Te ata bazë është që t’i jepet përparësi haberit (hadithit të vetmuar) absolutisht, sepse Ebu Hurejre ka qenë Fekijhë; edhe vetë Ebu Hanife e konsideron Fekijh. Ai e ka pranuar hadithin për prishjen e agjërimit. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: **“Kush ha ose pi me harresë, le të plotësojë agjërimin e tij, sepse Allahu e ka ushqyer dhe ia ka mundësuar të pijë”**.⁹²

Ebu Hanife ka thënë: Po të mos ishte ky transmetim, do ta kishte marrë për bazë Kijasin, pra prishjen e agjërimit.

Hanefijtë nuk e kanë pranuar hadithin e mosmjeljes së deles apo deles për shkaqe të tjera, jo duke e kritikuar sehabijen, si thënia: Hadithi është hadith Mudtarib, ose i shfuqizuar, ose nuk është vërtetuar vërtetësia e tij. Me një fjalë, dijetarët e kanë diskutuar, kanë gjetur arsye të mospranimit dhe në fund e kanë refuzuar. Seneani në librin **“Subule Selam”** shkruan: Hadithi është bazë për ndalimin e mashtrimit në shitblerje dhe ndalimin për mosmjelje të deles, para shitjes së tyre, dhe të drejtën e zgjedhjes së vazhdimit të kontratës ose prishjen e saj prej blerësit.

Medhhebi Malikij: Për të vepruar me hadithin e vetmuar, Imam Maliku e ka kushtëzuar që të mos jetë në kundërshtim me banorët Medinas,⁹³ sepse vepra e banorëve Medines zë vendin e transmetimit të Pejgamberit s.a.v.s. dhe si transmetim i një grupi të një grupi i cili është më prioritar se sa transmetimi i një personi të një person tjetër. Përpos kësaj, Medinasit janë më të diturit për ndonjë prej çështjeve apo gjendjeve të Pejgamberit s.a.v.s. Për këtë arsye, Malikijtë nuk e kanë pranuar **“Të drejtën e zgjedhjes (prishjes apo vazhdimit të kontratës) në**

kuvend, e jo më vonë. Është hadithi të cilin e ka transmetuar Hakim bin Hazani r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***Shitblerja është e drejtë zgjedhjeje përderisa nuk ndahen (shitësi dhe blerësi). Nëse kanë qenë të drejtë dhe kanë sqaruar pikat e shitblerjes, qoftë e bekuar shitblerja e tyre. Po, në qoftë se janë rrenacakë dhe fshejnë të metat e tyre, mos qoftë e bekuar shitblerja e tyre***⁹⁴.

Dijetarët e kanë debatuar mendimin e Imam Malikut për ixhmain e banorëve të Medinës, sepse ata nuk janë të pagabueshëm, për shkak se ata nuk përfaqësojnë të gjithë umetin, siç do të sqarojmë më vonë.

Medhhebi Shafii: Për të vepruar me hadithin e vetmuar, Imam Shafiiu kushtëzon katër kushte të përcipta dhe precize. Sipas mendimit të tij, ato janë:⁹⁵

1. Që transmetuesi të jetë i devotshëm në fenë e tij dhe i sinqertë në hadithin e tij.

2. Që të jetë i mençur, i logjikshëm në atë që thotë dhe ta dijë çka thotë, ashtu që të ketë mundësi ta transmetojë hadithin pikë për pikë, ashtu siç e ka dëgjuar, pa deformim të fjalëve, e jo që të transmetojë hadithin me kuptim.

3. Që të jetë i saktë në atë që transmeton, ashtu që ta ketë mbajtur përmendësh mirë, nëse nuk e përcjell hadithin prej librit të tij.

4. Që hadithi të mos jetë në kundërshtim me hadithet e dijetarëve, nëse që të dy hadithet flasin për të njëjtën tematikë. Këto kushte i kushtëzojnë te secila gjeneratë e transmetuesve derisa hadithi i pashkëputur të arrijë deri te Pejgamberi s.a.v.s., ose deri te tabiinët.

Me një fjalë, shart për të vepruar me hadithin e vetmuar te Shafiijt është zinxhiri i vërtetë dhe i pashkëputur. Për këtë arsye, Shafiijtë nuk kanë vepruar me hadithin mursal, por me kushtet të cilat do t'i sqaroj më vonë.

Medhhebi Hanbelij: Për të vepruar me hadithin e vetmuar, Imam Ahmedi kushtëzon që zinxhiri i transmetuesve të jetë i plotë dhe i drejtë, sikurse Shafiiu, përpos që e kundërshton Shafiiun sa i përket veprimit

me hadith mursel, sepse te Hanbelijtë veprohet me hadithin mursel. Mirëpo, te ata është hadith i dobët dhe i jepet përparësi fetvasë së shahabes ndaj hadithit të tillë.⁹⁶

Nga kjo kuptohet se Hanbelijtë janë fukahatë që më së shumti veprojnë me sunet, pastaj janë Malikijtë, më pas Shaffijt, e pastaj Hanefijtë. Bazë e mospajtimit është të marrit si rezervë dhe ngritjen e vlerës së sunetit.

Hanefijtë mendojnë se të vepruarit **“rezervë”** janë rregullat e përgjithshme.

Shumica absolute mendojnë se **“rezerva”** është të vepruarit me sunet sa më shumë të jetë e mundur.

Hadithi mursel

Në terminologjinë e muadithinëve **hadith mursel** është kur tabiiu nuk e përmend transmetuesin në mes tij dhe Pejgamberit s.a.v.s., që do të thotë: Muhamedi s.a.v.s. ka thënë.⁹⁷

Quhet kështu, sepse shkohet prej Muhamedit s.a.v.s., pra e thonë thënien e tij, por nuk e përmendin kush e ka dëgjuar prej tij.

Nëse bie (mungon) një shahabij, quhet hadith **munkatië**,

Nëse bien më shumë se një transmetues, quhet **“muadal”**.

Ndërsa, hadithi **“Mualak”** është që transmetohet, përpos tabiiut, pa zinxhirë.

Në terminologjinë e Usulijinëve hadithi mursel është thënia e drejtë, e cila nuk është ngjitur (takuar) te Pejgamberi s.a.v.s. (Muhamedi s.a.v.s. ka thënë), pa marrë parasysh se a është **“Munkatie, Muadal ose Mualak”**⁹⁸. Kjo ka interpretim më të gjerë se i muhadithinëve, sepse çdo hadith nuk e ka të ngjitur zinxhirin.

Dispozitat e hadithit mursel

Të gjithë dijetarët janë pajtuar se hadithi mursel, të cilin sehabiu e ka transmetuar, është hadith mursel i pranuar.⁹⁹ Për këtë është ixhmai, sepse çka transmeton sehabiju është se e ka bartur prej momentit kur e ka dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s., ose e ka dëgjuar prej sehabijut tjetër. Shabet që të gjithë janë të drejtë.

Ndërsa, për hadithin mursel, por jo të sehabjiut, dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Ata janë ndarë në katër mendime (Medhhebe).¹⁰⁰

Medhhebi i shumicës absolute, prej tyre Ebu Hanife, Maliku dhe Ahmed, është se hadithi mursel absolutisht është i pranuar, sa që pjesa dërmuese e Muëtezilëve thonë se hadithi mursel është më i fuqishëm se hadithi musnid, sepse ai i cili e ka ndërlidhur zinxhirin, të ka vëllazëruar ty, ndërsa ai i cili e ka ndërprerë, të ka afruar. Dijetari Shevkaniju thotë: Kjo është e tepruar dhe jashtë kornizave të realitetit.¹⁰¹

Medhhebi i Ibni Haxhibit dhe Ibni Hemamit është se hadithi mursel pranohet, por prej dijetarëve të cilët janë eminentë dhe të përpiktë, ndërsa prej të tjerëve jo. Kadiju Taxhudijnë ed-Sebekiju thotë: Në taborin e dijetarëve eminentë bëjnë pjesë shabet, tabinët dhe etbei tabiinët¹⁰².

Medhhebi i Isa bin Hebanit: Ai sqaron: Nëse hadithi mursel është hadith mursel i tri gjeneratave të para (sehaveve, taniinëve dhe tabi tabiinëve), pranohet absolutisht, pa marrë parasysh se a janë transmetuesit dijetarë eminentë, apo jo.

Medhhebi Shafii: Është në mes të atyre që e refuzojnë dhe të atyre që e pranojnë hadithin mursel. Këta e pranojnë hadithin, nëse i ka këto pesë çështje:¹⁰³

1. Që të jetë hadithi mursel prej tabiinivë, të cilët kanë qenë në prezencë të shumë sehaveve, si me Seid bin Musejebin, Zehran e të ngjashëm, te të cilët nuk përcillet hadithi, përpos çka është e sigurt, si Hasani, Shaëbiju dhe Ibni Sijrini. Ndërsa, nuk pranohet prej tabiinëve të vegjël.

2. Që ta vërtetojë hadithi musned kuptimisht.

3. Që të jetë hadithi mursel i pranuar, për të cilën pajtohen dijetarët.

4. Që ta vërtetojë thënia e sehabes.

5. Që të përforcohet me fetvatë e shumicës së dijetarëve; çdo renditje e këtyre është më e fortë se e para. Nëse hadithi mursel nuk e ka njëjërën prej këtyre çështjeve, hadithi mursel kthehet, nuk pranohet.

Medhhebi i Dhahirijëve dhe pjesa dërmuese e dijetarëve, si dhe disa Maitijnë, nuk e pranojnë hadithin mursel si argument.

Argumentet:

Secili medhheb i ka argumentet, të cilat do t'i tregoj në pika të shkurta:

Argumentet e medhhebit të parë: Është medhhebi i shumicës absolute të dijetarëve, të cilin e ka zgjedhur Amediju. Janë argumentuar logjikisht me atë se transmetuesi është i drejtë dhe besnik, kur thotë: **“Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë këtë”**; shihet qartë dhe në mënyrë të prerë se teksti është prej të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Shihet qartë nga gjendja e tij se ai nuk e lejon transmetimin, përpos çka është i sigurt në atë që e ka thënë Pejgamberi s.a.v.s, sepse, përndryshe, ai do të ishte mashtrues, tradhtar, cilësi të cilat janë të kundërta me besnikërinë dhe drejtësinë. Atëherë pra, thënia e Muhamedit s.a.v.s. e zë vendin e zinxhirit të fundit (isnadin). Argument për këtë e kemi thënien e Hasan el Basrijut: Kur u kam thënë juve: Më ka treguar filani, atëherë hadithi është i tij. E, kur u kam thënë: Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s., është prej shtatëdhjetëve.

Është kundërshtuar për këtë me thënien e Muhamed bin Sijrinit, i cili ka thënë: Mos i pranoni hadithet mursel ta Hasanit dhe Ebi Alijes, sepse ata nuk mërzhiten se nga i marrin hadithet.

I kundërpërgjigjemi për këtë se: Shkaku i mospranimi të hadithit prej tyre bëhet për shkak të padrejtësisë së tyre. E, kjo nuk është e domosdoshme të mos pranohet prej transmetuesve të tjerë.

Argumenti i Ibni Haxhibit: Është po i njëjti argument i mëparshëm. Se është çështje e prerë drejtësia e tekstit të Pejgamberit s.a.v.s., imponon ndryshimin e bazës (argumentit), i cili e ka rrëzuar hadithin musler. Nehaiu ka thënë: Kur të them se: Më ka treguar filani nga Abdullahu, këtë ai e ka treguar. Por, kur them se: Ka thënë Abdullahu, atë e kanë treguar më shumë se një transmetues.

Argumenti i Ibni Hebanit: Hadithi: Hadithi: **Gjenerata më e mira është gjenerata ime, pastaj ato që vijnë pas tyre, mandej ata që vijnë pas tyre, e pastaj do të përhapet rrena.**¹⁰⁴ Ky hadith e vërteton drejtësinë e shumicës së tri gjeneratave, nëse jo që të gjithë. Shumica e transmetuesve janë prej këtyre, sepse ata transmetojnë nga të drejtët dhe dëgjojnë hadithin e drejtë, e pas këtyre gjeneratave është përhapur rrena. E ka përjashtuar Ibn Hadithi nga kuptimi i fundit të hadithit që të jetë transmetuesi prej dijetarëve eminentë.

Argument i Shafiijut: Pranimi i hadithit të transmetuesit është i kushtëzuar që transmetuesi të njihet si i drejtë, sepse drejtësia është bazë për hadithin mursel, i cili nuk njihet, sepse njohja e tij është degë e njohjes së emrit të tij. Nëse nuk e dimë atë, atëherë bëhet e qartë se duhet të kthehet. Nëse hadithit mursel ia bashkangjesim njërin prej pesë çështjeve të sipërpërmendura, atëherë vërtetësia anon më shumë se sa rrena dhe pranimi është më i mirë. Ky argument është debatuar në tri pika:

Pika e parë: Transmetimi i drejtë prej bazës së heshtur do të thotë ndryshimi i atij transmetimi, sepse nëse tregon (transmeton) nga ai, që nuk është i drejtë, dhe nuk e tregon personifikimin e tij, ai do të ishte shpifës dhe mashtrues. I janë kundërpërgjegjur: Po e njëjta do të ishte nëse e drejta transmetohet nga i padrejti, gjithashtu.

Pika e dytë: Zinxhiri i hadithit mursel te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. është bazë e fortë e vërtetësisë, sepse zinxhiri i rrejshëm është e kundërta e drejtësisë. Nëse vërtetohet vërtetësia, bëhet e pranueshme.

I janë kundërpërgjigjur: Ne nuk e pranojmë se zinxhiri është bazë e fortë e vërtetësisë, por bazë është nëse transmetuesi dëgjon tjetrin, i cili transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s., e për të drejtin nuk dihet se është gënjeshtar, por dihet se është i sinqertë, ose nuk dihet gjendja e tij fare.

Pika e tretë: Sehabet kanë transmetuar shumë hadithe mursel dhe njerëzit i kanë pranuar ato.

I janë kundërpërgjigjur: Është e vërtetë se janë pranuar, sepse kështu ka peshuar mendimi se sehabet kanë dëgjuar hadithin prej Pejgamberit s.a.v.s., e të vepruarit me atë që peshon, është vaxhib.

Dhahirijtë dhe Muhadithinët janë argumentuar sa vijon:

E para: Prej atij që është marrë transmetimi nuk dihet personi. Mosnjohja e personit, do të thotë mosnjohja e personalitetit, ndërsa, të gjithë janë të pajtimit se mosnjohja e personalitetit është shkak për mospranimin e hadithit.

E dyta: Po të pranohej hadithi mursel, nuk do të kishte pasur vlerë zinxhiri i haditheve.

U janë kundërpërgjigjur atyre: Transmetimi i dijetarëve transmetues është argument se ata e dinë personalitetin e atij, prej të cilit e pranojnë transmetimin, dhe ata e kanë vërtetuar vërtetësinë e tij, sepse, përndryshe nuk do të kishte asgjë të sigurt, posaçërisht pasi që ata janë dijetarë eminentë dhe të identifikuar si transmetues, edhe pse nuk dihet gjendja e të më poshtmit, sepse drejtësia e atij, prej të cilit është marrë transmetimi, është tashmë e njohur. Nuk ka pengesë për pranimin e hadithit mursel në kohën e sotme, përderisa është vërtetuar se hadithet mursel i kanë plotësuar kushtet e pranimin. Në zinxhir të haditheve ekziston vlera dhe arsyeja, sepse në të kuptohet sqarimi, sepse dëshmon gjendjen e transmetuesve, ndërsa me hadith mursel, në të tregohet

globalisht. Për këtë arsye, hadithi musnid (zinxhiror) është më i fuqishëm se hadithi mursel (jozinxhiror).

6. Veprat e Pejgamberit s.a.v.s.

Veprat e Pejgamberi s.a.v.s. janë tri llojesh:¹⁰⁵

E para: Veprat personale, të cilat i ka kryer Pejgamberi s.a.v.s., si f.v. të ecurit, të ulurit, të ngrënit, të pirit. Për këto veprime nuk ka kundërshtim se janë të lejuara (mubah) për të, por edhe për umetin (muslimanët). Kryerja e veprimeve të këtij lloji për neve nuk janë vaxhib (obligim).

I këtij mendimi është drejtimi (medhhebi) i shumicës absolute të dijetarëve.

Një pjesë e dijetarëve kanë thënë se këto vepra janë mendub (të pëlqyera). Allahu është i njohur se Abdullah bin Omeri r.a. i ka vepruar këto vepra dhe ka pasur dëshirë që ta bëjë traditë të veprojnë si Pejgamberi s.a.v.s. në çdo gjë çka ka buruar prej Muhamedit a.s e, edhe prej veprave të rëndomta.

E dyta: Veprimet të cilat sipas natyrshmërisë kanë qenë specifika të Pejgamberit s.a.v.s. si f.v.:

- lejimi i agjërimit dyditësh (48 orë). Agjërimi 48 orësh ka qenë specifikë e Pejgamberit s.a.v.s. Ky lloj agjërimi për Muhamedin a.s. ka qenë vaxhib

- po ashtu, ka qenë vaxhib edhe Namazi i Duhasë (mesditës), Namazi i vitrit, namazi i natës,

- lejimi për t'u martuar me më shumë se me katër gra. etj etj.

Dispozita e këtyre specifikave të tij: këto specifika nuk pasohen, sepse kanë qenë posaçërisht për pejgamberin s.a.v.s.

E treta: Veprimet që nuk kanë lidhje me të parat, por qëllimi është ligjësimi.

Këto vepra duhet t'i pasojmë, mirëpo ligjësimi i veprave ndryshon varësisht prej veprës, që do të thotë:

Një vepër mund të jetë: vaxhib (obligative),

Një vepër mund të jetë mendub (e pëlqyer) ose

Një vepër mund të jetë mubah (e lejuar).

Këto ligjësi kuptohen me sa vijon:

a. Nëse veprimet janë sqarim i asaj çka nuk kanë qenë të sqaruara në Kur'an, apo veprimet kanë qenë përkufizim dhe përcaktim i asaj çka nuk ka qenë e përkufizuar në Kur'an ose veprime të cilat kanë specifikuar gjeneralën.

Dispozita është në mes të vaxhibit dhe Mendubit. Sqarimi kuptohet ose me fjalë të qartë, siç është thënia e Pejgamberit s.a.v.s. ***“Faluni siç më shihni duke falur”***.¹⁰⁶

Në haxh ka thënë: ***“Pranoni prej meje mënyrën e rregullave të juaja (në haxh)”***.¹⁰⁷

- Ose me ndonjë faktor tjetër, si veprimi i tij për të sqaruar një çështje kur e kërkon nevoja, si f.v.: Prerja e dorës së vjedhësit deri në fund të shuplakës. Ky është sqarimi i thënies së Zotit të Lartmadhëruar ***“Jepni mes’h fytyrave tuaja dhe duarve tuaja”***.

Në këto raste, sqarimi është pasimi i të sqaruarës në vaxhib, mendub dhe mubah.¹⁰⁸

b. – Nëse vepra nuk është veprim i sqarimit të Kur'anit, por vepron në vetvete që nga fillimi, ajo vepër ose është në vetvete që nga fillimi, ajo vepër është e njohur si atribut sheriativ, ose nuk njihet ashtu.

Nëse njihet atributi si vaxhib, Mendub ose Mubah, Umeti e vepron ashtu siç cilësohet. Ky është mendimi më i drejtë. Siç ka thënë Shevkaniju: Argument për këtë është Kur'ani dhe veprimi i sehavebe.¹⁰⁹

Sa i përket Kuranit, është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Çka u jep (urdhëron) i Dërguari, merreni dhe çka ju ndalon, ndalohuni.”;

“Nëse dëshironi ta doni Allahun, më pasoni mua.”;

“Le të kenë kujdes ata që kundërshtojnë urdhrin e tij.”;

“Ju veç për juve keni të dërguarin e Allahut shëmbëlltyrën më të mirë.”;

“Dëgjoni Allahun dhe dëgjoni të dërguarin.”.

Sa i përket sehavebe, në shumë raste, kur argumentoheshin, apo kur u nevojitej mbështetje, gjithmonë bazoheshin në veprat e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, ashtu siç ka vepruar Omer bin Hatabi me rastin e puthjes

së haxherul Esvedit, kur ka thënë ***“Po mos ta kisha parë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke të puthur nuk do të të puthsha”***.¹¹⁰

Nëse nuk dihet atributi sheriativ, analizohet:

- Nëse shihet se veprimi është çështje adhurimi, apo afrim tek Allahu, pra është vepër që afron tek Allahu i Lartmadhëruar, siç janë dy rekate namaz jo të rregullta, kjo tregon se ajo vepër është Mendub (e pëlqyer),¹¹¹ sepse kjo është minimumi i dy anëve, sepse kur kuptohet se qëllimi është afrim tek Allahu, është argument se vepra është vetëm e kërkuar. Imam Maliku ka thënë: Tregon se vepra është vaxhib (obligim), sepse është urdhër për të pasuar të Dërguarin a.s. E, urdhri tregon vaxhibin (obligimin).¹¹²

- Nëse nuk kuptohet se qëllimi është afrim tek Allahu, si f.v shitblerja, bujqësia, Imam Maliku dhe Kerhiju thonë: tregon se vepra është Mubah (e lejuar), sepse është masa e sigurt, e cila buron prej veprës, e, më shumë se kjo, nuk vendoset asgjë më shumë, përpos se me argument.¹¹³ Këtë mendim e ka zgjedhur Ibni Haxhibi. Shafiiju ka thënë: Vepra tregon se është mendub (e pëlqyer), sepse prej veprës nëse nuk vërehet me fjalë të tjera, nuk kuptohet se qëllimi është afrimit tek Allahu; ajo vepër patjetër tregon se është afrim tek Allahu, por të nivelit të Mendubit (e pëlqyer). Këtë mendim e ndajnë shumica e Hanefijve dhe Muëtezilëve.

Amediju dhe Esneviju e ndajnë këtë mendim: Nëse kuptohet apo vërehet se qëllimi i veprës është afrim tek Allahu, është argument i dispozitave të dyfishta në mes të vaxhibit dhe mendubit. E, kjo është dhënie përparësi veprës, e jo vetëm për ta lënë të padefinuar, por e ligjësuar. Ndërsa, në rast se kuptohet, apo vërehet se vepra nuk është afrim tek Allahu, është argument i dispozitës në mes të vaxhibit, Mendubit dhe Mubahit. Kjo është largimi i vështirësisë prej veprës.¹¹⁴ Ky është mendimi, të cilin e përkrah dhe e preferoj. Ka edhe mendime të tjera, të cilat nuk i kanë paraqitur dhe nuk i kanë sqaruar me argumente. Mjaftojnë ato që i kam përmendur.

Kundërshtimi i fjalëve me veprat e Pejgamberit s.a.v.s.

Kundërshtimi në mes dy çështjeve është konfrontimi në mes dy çështjeve në atë mënyrë sa që çdo njeri e pengon që të ketë mbështetje të tjetra. Kjo, nga atë që e mendon muxhtehidi e jo kundërshtimi në vet çështjen, sepse në sheriat nuk ka çështje kontradiktore në mes vete.¹¹⁵ Biseda për këtë përfshin tri mundësi.

E para: Kundërshtimi në mes dy veprimeve:

Usulijinët kanë vendosur se është e pamundur dhe e paimagjinuar që të ndodhë kundërshtim në mes dy veprimeve, ashtu që njëra të jetë shfuqizimi i tjetrës, sepse nëse nuk kundërshtohen dispozitat e dy veprimeve, nuk ka kundërshtim. Por, edhe nëse kundërshtohen, prapëseprapë nuk ka kundërshtim, sepse **“të ngjashmet”**, si f.v.: Namazi i drekës në dy kohë të ndryshme është i lejuar, që të jenë dy veprimet në të njëjtën kohë; si f.v. Namazi dhe agjërimi. Siç shihet nuk ka kundërshtim në mes tyre (namazit dhe agjëritimit në të njëjtën kohë).¹¹⁶

Ndërsa, dy veprimet, të cilat askush nuk mund t’i paramendojë që të bëhen në të njëjtën kohë, dispozitat janë në kundërshtim me njëra tjetrën, si f.v.: Nëse në një kohë agjëron, e po ashtu në atë kohë ha (nuk agjëron). Nuk ka kundërshtim në mes tyre, Sepse lejohet që veprimi në një kohë mund të jetë vaxhib, Mendub ose i lejuar. Dhe, kështu, në të njëjtën kohë, në të kundërtën e veprës së parë, por pa e prishur dispozitën e parë, sepse, siç thonë Usulijinët: Nuk ka përgjithësim të veprës. Nuk përfshin të gjitha (pjesët) kohërat e ardhshme, e kjo nuk tregon përsëritjen.

Mirëpo, nëse për veprën e parë është fjala e cila kërkon obligueshmërinë e përsëritjes, atëherë vepra mund të jetë e shfuqizuar, ose specifikues i fjalës. Kjo është sikurse e sqaroj fjalën, e jo vetë veprën. E, atëherë pra, në esencë nuk ka ardhur deri te kundërshtimi në mes të dy veprimeve.

E dyta: Kundërshtimi në mes të dy fjalimeve.

Kjo ka të bëjë kur në përgjithësi kundërshtohen dy tekste, kur të kundërshtohen dy fjalime të vetë të Dërguarit të Allahu s.a.v.s. Kjo, siç është sqaruar, është sipas asaj siç e sheh muxhtehidi, e jo siç është në realitet në esencë të çështjes, e kjo, shikuar në bazë të zbulimit të fshehtësisë së qëllimit të fjalës, ose për shkaqe tjera.

Te shumica absolute e dijetarëve (përpos Hanefijve) ekzistojnë katër etapa për të larguar dhe eliminuar kundërshtimin.¹¹⁷

E para: Bashkimi dhe harmonizimi në mes të fjalimeve të kundërta mes vete, ashtu që secilit fjalim i japim atë kuptim, të cilën nuk e ka tjetra, si f.v: Bashkimi në mes të përgjithësimit dhe llojeve të saj, në mes të të papërcaktuarës dhe të përcaktuarës, ose dhënies së njërës fjalë kuptim metaforik, ose në mes të së përgjithshmes dhe të veçantës me përveçësim; sepse të vepruarit me dy argumente është më mirë se me mosveprimin e tyre në tërësi; sepse esenciale është: kur të arrihet deri te argumenti, më mirë është të veprohet me të se sa të mos veprohet.

E dyta: Përparësia e njërës prej tyre, nëse nuk ka mundësi të bashkohen. Përparësia mund të jetë:

- ose në tekste, pra tëherë atëher kur i jepet përparësi tekstit më të fuqishëm ndaj atij më të dobët, si f.v.: i jepet përparësi tekstit më të sqaruar (Muhkem) ndaj atij të sqaruar (mufesir), fjalës treguese ndaj asaj analizuese,

- ose nëpërmjet zinxhirit. I jepet përparësi hadithit mutevatir ndaj atij jo mutevatir, hadithit meshhur ndaj hadithit të vetmuar; pastaj i jepet përparësi haditheve që janë më shumë të argumentuara, mandej i jepet përparësi transmetuesit fekih, ose të drejtë, ose të përpiktë, ose tepër të ditur, ose besimit të drejtë e të ngjashme;

- ose nëpërmjet hadithit tregues, si urdhëruese, lejuese dhe mohuese. Te shumica absolute e dijetarëve i jepet përparësi urdhrit ndaj

të lejuarës, mohueses ndaj vërtetueses, ose të kundërtës, varësisht prej mospajtimit të dijetarëve;

- ose nga aspekti i ndonjë fakti të jashtëm, si pajtueshmëria e një argumenti me një argument tjetër të Kur'anit, sunetit apo ixhmait.

Disa usulijinë, si Hanefijtë, i japin prioritet të preferuarës ndaj bashkimit të argumenteve.¹¹⁸

E treta: -Shfuqizimi i një thënieje prej një thënieje tjetër. Nëse janë të barabartë për nga fuqia argumentuese, nga aspekti i përgjithshëm dhe nga dituria se njëra thënie është e mëvonshme, atëherë shfuqizohet thënia e mëhershme.

E katërta: Mosveprimi i të dy thënieve së bashku, kur nuk dihet se cila prej thënieve është e mëvonshme, ose është e pamundur bashkimi i të dy thënieve, ose nuk mund t'i jepet njëres thënie prioritet ndaj tjetrës, atëherë nuk veprohet me asnjërën prej tyre, për shkak të kundërshtimit të ndërsjelltë.

Sqarimi i gjithë kësaj do të bëhet kur do të flasim për temën: Kundërshtimi në mes të argumenteve dhe prioriteti i njëres ndaj tjetrës.

E treta: Kundërshtimi i fjalës me veprën.

Ky është qëllimi kryesor dhe thelbësor këtu. *Shembull:* Ndalesa e Pejgamberit s.a.v.s. për t'u kthyer në drejtim të kibles, ose të kthyerit e shpinës gjatë kryerjes së nevojës, urinimit, ose të ulurit për të kryer nevojë në shtëpi, ku shtëpia është në drejtim të shtëpisë së shenjtë.

Nëse ndodh konfrontimi në mes thënies dhe veprës së Pejgamberit s.a.v.s., atëherë i kemi tri raste:¹¹⁹

Ose mund të jetë fjala para veprës,

Ose vepra para fjalës,

Ose nuk dihet a vepra, a fjala është përpara.

1. Nëse fjala është para veprimit, si f.v: nëse Pejgamberi s.a.v.s. e vepron një vepër dhe paraqitet një argument, i cili na obligon neve ta pasojmë, atëherë vepra është shfuqizues i fjalës së mëhershme, e cila është në kundërshtim me të, pa marrë parasysh se ajo fjalë a është e përgjithshme, e veçantë për të, ose e veçantë për ne. *Shembulli i të parës*: i cili është i përgjithshëm, është kur thotë: Agjërimi i kësaj dite është vaxhib për ne, pastaj Pejgamberi s.a.v.s. e agjëron atë ditë. Ndërsa, sa i përket kundërshtimit të fjalës dhe veprës, të cilat janë posaçërisht specifika vetëm për Pejgamberin s.a.v.s., nuk reflekton asgjë te umeti i tij.

Nëse nuk tregon asnjë argument se është vaxhib për ne ta pasojmë në atë vepër, si f.v. veprimet personale të tij për veten e tij, atëherë vepra nuk është shfuqizim i fjalës, por posaçërisht për të, nëse fjala, e cila është e mëhershme, por është e përgjithshme, e nuk ka vepruar sipas asaj fjale.

2. Nëse fjala është më e vonshme se veprimi, fjalë e cila tregon se është vaxhib për ne që ta pasojmë. *Shembull*: Pejgamberi s.a.v.s. fjalët në drejtim të mesxhidi aksasë. E, pastaj thotë: Namazi në drejtim të mesxhidi aksasë nuk lejohet. Këtu janë tri raste, nëse dëshmohet me argument për obligueshmërinë që Pejgamberi s.a.v.s. dhe umeti i tij ta përsërisin. Nëse nuk tregohet me argument për përsëritjen e atij veprimi, atëherë nuk ka konfrontim në mes të veprës dhe fjalës.

a. **Nëse fjala e mëvonshme është e përgjithshme**, pra e përfshin Pejgamberin s.a.v.s. dhe umetin e tij, atëherë ajo fjalë shfuqizon veprimin e mëhershëm, si p.sh.: e agjëron ditën e Ashurës dhe paraqitet një argument për obligueshmërinë e përsëritjes dhe ngarkesë për neve për ta agjëruar. Pastaj, Pejgamberi s.a.v.s. thotë: Nuk është vaxhib për ne që ta agjërojmë këtë ditë. Kjo fjalë shfuqizon veprën e mëhershme.

b. **Nëse fjala e mëhershme është posaçërisht për Pejgamberin s.a.v.s.**, nëse thotë sikurse në rastin (shembullin) e mëhershëm: Nuk e kam vaxhib që unë të agjëroj, atëherë shfuqizimi i këtij ligji është posaçërisht për Pejgamberi s.a.v.s. Ndërsa, për umetin nuk është në kundërshtim fjala me veprën, sepse fjala nuk i drejtohet umetit, por vazhdon ngarkesa për ta.

c. **Nëse fjala e mëvonshme është posaçërisht për umetin**, nëse thotë sikurse në rastin (shembullin) e mëparshëm: Nuk e keni vaxhib që ju të agjëroni, nuk ka kundërshtim në mes të fjalës dhe veprës, sa i përket Muhamedit s.a.v.s. sepse vazhdon ngarkesa për të, ndërsa sa i përket umetit, fjala tregon se nuk janë të ngarkuar me atë veprim. Vetëm se, nëse fjala është para veprimit të një vepre sonë, atëherë është posaçërisht për veprën e mëhershme, pra sqarim se nuk është vaxhib, dhe nëse fjala vjen pas kryerjes së veprimit, është shfuqizim i veprës së mëvonshme. Sqarim i mëtutjeshëm do të bëhet kur do të flasim për shfuqizimin.

3. **Nëse fjala është e mëvonshme, por veprimi nuk dihet, a i mëvonshëm, a më i hershëm**, këtu paraqitet kontrasti i të dyjave të fuqishmeve. Nëse ka mundësi, bëhet bashkimi në mes të fjalës dhe veprës, duke specifikuar njërën nga tjetra. Siç sqaruam më parë, nëse nuk ka mundësi të bëhet bashkimi, atëherë dijetarët kanë dhënë tri mendime.

Mendimi i parë: Është mendimi i Razijut, shumicës absolute të dijetarëve dhe të cilin e preferoj unë: **i jepet prioritet fjalës**, sepse tregon qëllimin pa ndërmjetësues, ndërsa vepra nuk është mjet i vendosur për të treguar. Por, edhe nëse tregon, vepra tregohet me ndërmjetësim **“fjalë”**. **Shembull: “Faluni siç më shihni duke u falur”**. Pastaj, treguesi i veprës, pra të falurit e Pejgamberi s.a.v.s., është arritur (realizuar) nëpërmjet ndërmjetësuesit të kësaj fjale.

Mendimi i dytë: I jepet përparësi veprës, sepse vepra është më treguese dhe më sqaruese e argumentimit, sepse teoritë (idetë) teknologjike dhe fjalët e inxhinierëve kanë nevojë për sqarimin e veprës në letër, duke përshkruar me skicim.

Është kundërpërgjigjur ky mendim me atë se vepra e inxhinierit është rrugë sqaruese, mirëpo shumica e dispozitave mbështetjen e kanë fjalën, e jo veprën, duke pasur parasysh fuqinë treguese që kanë dhe që atyre fjalëve nuk i jepet alternativë tjetër e argumentimit.

Mendimi i tretë: -Duhet ndalur dhe duhet analizuar se a janë të barabarta në fuqi treguese fjala dhe vepra për të qenë obligim për të vepruar me njërën prej atyre dyjave.

Fusnotat:

1. E ka regjistruar Abdul Berri. Ibn Hazmi, si refuzues i Kijasit, është munduar ta degradojë këtë hadith, duke thënë: shihet se ky hadith është shpikës dhe gënjeshtër (“El-Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq.976, mirëpo në fakt hadithi është hadith mursel. Gjithashtu, e ka regjistruar Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Muadh bin Xhebeli nëpërmjet sehabëve të besueshëm (“Nasbu Rraje” vëll. i IV fq.73).

2. “Hashijetu Taftazani ala sherhil udad ala muhtesar el muntehi” vëll. i II fq.18.

3. “El-Ihkam” vëll. i I fq.82;
“Hashijetu Taftazani”;
“Et-Telvijh alet-Tevdijh” vëll. i I fq.29;
“Sherhul mehalij” vëll. i I fq.159;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.213;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.7;
“Mer’etil Usul” vëll. i I fq.97;
“Sherhul Esnevi” vëll. i I fq.204;
“Revdatu Nadhir” vëll. i I fq.178;
“El med’hal ila medhheb Ahmed” fq.88;
“Irshadul Fuhul” fq.26.

4. “El mustesfa” vëll. i I fq.68;
“Revdatu Nadhir” vëll. i I fq.184.

5. “Mer’etil Usul” vëll. i I fq.106.

6. “Keshful Esrarë” vëll. i I fq.24.

7. “Et-Telvijh alet-Tevdijh” vëll. i I fq.21;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.212;
“Mer’etil Usul” vëll. i I fq.109;
“Hashijetul Nesmatul Es’har” fq.14.

8. “El-mustesfa” vëll. i I fq.63.
9. “Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.9.
10. “Mer’etil Usul” vëll. i I fq.99
11. “El-med’hal ila medhheb Ahmed” fq.88.
12. “Muslimu Thubut” vëll. i II fq.8;
“Irshadul Fuhul” fq.27.

13. Ibn Xhezeriu thotë: Shatibiu është përkufizuar në shtatë kiraetet, Tre Kiraetet tjera janë të Ebi Xheferit, Jakubit dhe Halefit. Mutevatir: është dituri e domosdoshme (“Ulumul Kur’an lis-Sujuti” vëll. i I fq.82);

“Muslimu Thubut”;
“Sherhul mehalij”;
“Mer’etil Usul”;
“Gajetul Vusul”;
“El anavijn fil mesailul Usulije”.

14. “Muslimu Thubut”.

15. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.216;
“Revdatu Nadhir” vëll. i I fq.181.

16. “El Mustesfa” vëll. i I fq.65;
“El-Ihkam” vëll. i I fq.83;
“Sherhul Udad” vëll. i II fq.21;
“Sherhul xhelalul mehalij” vëll. i I fq.167;
“Irshadul Fuhul” fq.27.

17. “El mustesfa” vëll. i I fq.65;
“El Ihkam” vëll. i I fq.84;
“Sherhul mehalij” vëll. i I fq.163.

18. “El Itkan fi ulumul Kur’an” vëll. i I fq.8.

19. “Sherhul mehalij”
“Sherhul Udad” vëll. i II fq.19;
“Meratibul Ixhmaë li Ibni Hazm” fq.174.

20. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.216;

“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.14;

“Mer’etil Usul” vëll. i I fq.102.

21. “Tefsir Ibni Kethirë” vëll. i I fq.17;

“Subules-Selam” vëll. i I fq.172.

22. Transmeton Daruutni.

Ngjashëm është transmetuar nga Ali Ibn Abasi dhe të tjerë (“Tefsir Ibni Kethiri” vëll. i I fq.16) (“Subule Selam” vëll. i I fq.173).

23. “Irshadul Fuhul” fq.27.

24. “Sherhul Udad” vëll. i II fq.190;

“Mer’etil Usul” vëll. i I fq.101;

“Muslimu Thubut” vëll. i II fq.6.

25. “Tefsirë Ibni Kethirë” vëll. i I fq.17.

26. “Iëxhazul Kur’an lil Bakilani” fq.23-50;

“Iëxhazul Kur’an lir-Rafij” fq.187;

“Usulul Fikh lil Halaf” fq.28;

“Muhaderat fi Usuli Fikh” fq.66.

27. Transmeton Trimidhiu nga Ali bin Talibi r.a.

28. “Usulul Fikh lil Halaf” fq.23;

“Muhaderat fi Usuli Fikh” fq.68.

30.Këtë e ka squruar autori i librit të kohës së sotme ”Attharul Harbi fi fikhil Islam-Derasatul mukarene

30. En-Nahl 90-91.

31. “Usulul Fikh li Zekiju dijn Shaëban” fq.23;

“Usulul Fikh lil Halaf”.

32. “Usulul Fikh li Shaëban” fq.144.

33. “Irshadul Fuhul” fq.28.

34. “Usulul Fikh li Shaëban” fq.26.

35. “Usulul Fikh lil Hudarij” fq.205.

36. “El Ihkam lil Amidij” vëll. i I fq.87;
 “Sherhul Xhelalul mehalij” vëll. i II fq.82;
 “Sherhul Udadi” vëll. i II fq.22;
 “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.223;
 “Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.97;
 “Mer’etil Usul” vëll. i I fq.196;
 “El-Ibhaxh” vëll. i I fq.170;
 “Sherhul Esnevij” vëll. i II fq.228;
 “El med’hal ila medhheb Ahmed” fq.89.

37. “Irshadul Fuhul” fq.23;
 “Muhaderat fi Usulil Fikh” fq.72.

38. “Sherhul Udadi” vëll. i II fq.52;
 -Transmeton Ahmed dhe gjashtë koleksionistët përpos Tirmidhiut nga Ibni Abasi (“Nejlul Evtar” vëll. i VIII fq.118).
 -Transmeton Ahmed dhe gjashtë koleksionistët nga Aishja (“Nejlul Evtarë” vëll. i VI fq.282).

40. “Usulu Shashi” fq.81;
 “El Mustesfa” vëll. i I fq.93;
 “El Ibhaxh” vëll. i II fq.186;
 “Irshadul Fuhul” fq.41.

41. “Et-Telvijh alet-Tevdijh” vëll. i II fq.3;
 “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.225;
 “Mer’etil Usul” vëll. i II fq.200.

42. Për t’u plotësuar hadithi mutevatir nevojiten tre kushte:

Kushti i parë: Që transmetimi të ketë mbështetje në shqisa, e jo vetëm në logjikë (kjo do të thotë që të perceptohet me njërën prej pesë shqisave), sepse logjika (mendimi) ndonjëherë gabon, e është e mundur që argumenti të zbehet, ndërsa nëpërmjet shqisave tjera kjo nuk mund të ndodhë, dhe nevojitet që argumenti të përsëritet.

Kushti i dytë: Që të bëhet balancimi i dy anëve dhe i anës mesatare, për shkak të argumenteve të shumta (Kjo sipas mendimit të Ebi Hanifës).

Kushti i tretë: Që transmetiet të jenë të shumta ashtu që të jetë e pamundur që transmetuesit të bashkohen në gënjeshtër për shkak të vendeve të ndryshme, ashtu siç ka ndodhur gabimi me rastin e kryqëzimit të Mesihut (Isa a.s.) (Mustesfa vëll. I fq.86);

“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i I fq.223;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.115;
“El-Ibhaxh” vëll. i II fq.187;
“Sherhul Esneviju” vëll. i II fq.271;
“Hashijetu Nesmatu Es’har” fq.194;
“Irshadul Fuhul” fq.41;
“El Med’hal ila Medhheb Ahmed” fq.91.

43. Hadith Mutevatir, e kanë treguar 12 sehabë. Prej Alijut r.a. e kanë regjistruar: Ibn Shejbe, Darukutnij dhe Ibni Adij.

44. Hadith Mutevatir. E ka regjistruar Ahmedi dhe gjashtë koleksionistët nga Enesi r.a. E kanë treguar Zubejri, Ebu Hurejre, Xhabir bin Abdullahu, Ibn Mes’udi, etj.

45. Hadith Mutevatir. Transmeton Muslimi nga Ebi Hurejre. Transmeton Ahmedi nga Xhabiri (“Nejlul Evtar” vëll. i I fq.169).

46. “El Ihkam” vëll. i I fq.151;
“El-Lema lil Shijrazij” fq.28;
“Keshful Esrarë” vëll. i I fq.280;
“Et-Telvijh alet-Tevdijh” vëll. i II fq.3;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.235;
“El-Ibhaxh” vëll. i II fq.186;
“Mer’etil Usul” vëll. i II fq.200;
“El mebadiul ameti lil Fikhil xheaferij” fq.329.

47. “Sherhul Xhelalul mehalij” vëll. i II fq.106;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.223;
“El-Ibhaxh” vëll. i II fq.189;
“En-Nudhumul mutenathir minel hadijthil mutevatir lis-Sejid Kenanij” fq.10

48. “Et-Telvijh alet-Tevdijh” fq.212;
“Keshful Esrarë” vëll. i I fq.688;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.235;
“Sherhul mehalij” vëll. i I fq.114;
“Mer’etil Usul” vëll. i II fq.2004.

49. Hadithin e parë e ka regjistruar Muslimi nga Omeri r.a. Hadithin e dytë e ka regjistruar Buhariu dhe Muslimi nga Ibn Omeri r.a. Hadithin e tretë e ka regjistruar Darukutni dhe të tjerët nga Ebi Seid el Hudriju. Po ashtu, e ka regjistruar

Ahmedi dhe Buhariu nga Ibn Omeri e ai nga Seadi (“Nejlul Evtar” vëll. i I fq.176, 178).

Hadithin e “gurëzimit” e ka regjistruar një grup seleksionistësh (Ahmedi dhe gjashtë koleksionistët nga Ebi Hurejre dhe nga Zejd bin Halidi) (“Nejlul Evtar” vëll. i VII fq.86).

50. “Hashijetul Nesmatul Es’har” të Ibni Abidinit fq.195.

51. “Keshful Esrarë” vëll. i I fq.690;

“El Mustesfa” fq.93;

“Muslimu Thubut” vëll. i II fq.88;

“Mer’etil Usul” vëll. i II fq.204;

“Hashijetu nesmatul Es’har”

“Et-Telvijh alet-Tevdijh” fq.22;

“Sherhul mehalij” vëll. i II fq.114;

“Revdatu Nadhir” vëll. i I fq.260;

“Gajetul Vusul Sherh Lubul Usul” fq.97;

“El-med’hal ila medhheb Ahmed” fq.91;

“El Mebadiul ameti lil fikhil Xheafer” fq.342;

“Irshadul Fuhul” fq.43.

52. “El-Ihkam lil Amidi”.

53. “Muhaderat fi Usulil Fikh” fq.74.

54. E ka regjistruar Maliku në Muvetaë;

“Xhamiul Usul” vëll. i I fq.186;

E ka regjistruar Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Mikdam bin Mead Jekreb (“Xhamiul Usul” vëll. i I fq.190).

54. Profesor Muhamed Tekijul Hakimë ka thënë: Ky është argument, të cilin e tregojnë argumentuesit e hadithit, dhe në aspektin logjik argument kundërmohues të hadithit dhe të peygamberllëkut (“Usulul ameti lil fikhil mukaren” fq.128).

55. “El med’hal ila medhheb Ahmed” fq.90.

56. “Muhaderat el Bena” fq.75.

57. Mutefikun alejhi nga Ibn Mes’udi (“Nejlul evtar” vëll. i VI fq.190).

58. “El med’hal ila medhheb Ahmed” fq.90.

335. “En-nedhar” fq.247.

59. Transmeton Darukutniju nga Enes bin Maliku (“Nejlul Evtar” vëll. i V fq.216).

60. Transmeton Muslimi nga Ebi Hurejre në formulimin “silluni mirë me gratë” (“Sherhul Muslim” vëll. i X fq.58).

Transmeton Tirmidhiu nga Amr bin Ehves në formulimin “E pra, silluni mirë me gra”.

61. Transmeton Ahmedi, Nesaiju, Ebu Davudi dhe dy shejhat nga Ebi Hurejre (“Nejlul Evtar” vëll. i VI fq.146).

62. Transmeton Ahmedi, Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiju dhe Ibni Maxhe nga Ibni Abasi (“Nejlul Evtar” vëll. i VI fq.74).

63. Transmeton Ebu Davudi nga Amër bin Shuajbin, nga baba i tij, nga gjyshi i tij (“Nejlul Evtar” vëll. i VI fq.74).

64. Për të ka edhe hadithe tjera, prej tyre hadithin të cilin e ka regjistruar Darukutniju nga Amër bin Shuajbi, nga gjyshi i tij për rastin e vjedhjes së Safvan bin Umejes, pastaj rasti tjetër “Dhe urdhëroi t’i pritet dora deri në fillim të shuplakës (“Nasbu Rraje” vëll. i II fq.27).

65. Mutefikun alejhi, nga Othman bin Afvani r.a. (“Nejlul Evtar” vëll. i I fq.129).

66. Hadith mutevatir.

67. Transmeton Muslimi në formulimin: Njerëzit pasojnë kurejshitët në të mirë dhe në të keqe.

Buhariu dhe Muslimi nga Ebi Hurejre në formulimin “Në këtë çështje njerëzit pasojnë Kurejshitët” (“Xhamiul Usul” vëll. i IV fq.347).

Transmeton Taberaniu në librin “Sagirë” dhe “Evsat” në formulimin “udhëheqësit Kurejshit” (“Mexhmea Zevaid” vëll. i V fq.192).

68. Hadithi “Nuk trashëgohe mi, por pasuria jonë mbetet sadaka” është hadith Mutefikun alejhi nga Ebi Bekri (“Nejlul Evtarë” vëll. i VI fq.76).

69. Transmeton Ahmedi, Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Kubijsete bin Dhuejb (“Nejlul Evtar” vëll. i VI fq.59).

70. Transmeton Nesaiju (“Nejlul Evtar” vëll. i VII fq.57).
71. Transmeton Shafiiju (“Nejlul Evtar” vëll. i VII fq.56).
72. Transmeton Ahmedi dhe katër koleksionistët (“Nejlul Evtar” vëll. i VI fq.298).
73. Transmeton Ahmedi dhe Muslimi nga Ebi Seid el Hudriju (“Nejlul Evtar” vëll. i V fq.190).
74. Transmeton Muslimi dhe Ahmedi ndërsa e ka vërtetuar Tirmidhiu (“Nejlul Evtar” vëll. i I fq.221).
75. “Keshful Esrarë” vëll. i I fq.694.
76. Transmeton Maliku, Ahmedi, dy shejhat dhe Ebu Davudi nga Ebi Musa el-Esh’ariju dhe Ebi Said el Hudriju.
77. Transmeton Ahmedi dhe gjashtë koleksionistët e haditheve përpos Buhariut (“Nejlul Evtar” vëll. i VI fq.301).
78. Mutefikun alejhi nga Ibn Omeri (“Nejlul Evtar” vëll. i IV fq.102).
79. Hadithë mutevatir. E ka transmetuar Ahmedi, Tirmidhiu dhe Ibni Habani nga Ibni Mes’udi.
Po ashtu e ka transmetuar Tirmidhiu nga Zejd bin Thabiti.
84. Shiitët pajtohen se informata e vetme është argument (“Anavijn fil mesail Usulije lil Kjadhimij” vëll. i II fq.10,
“El Kavanijn Mahkemeti lil Xhejlaniu” fq.198,
“Usulul Istınbat lil Hajderij” fq.147).
85. “Muslimu Thubut” vëll. i II fq.97;
“Keshful Esrarë” vëll. i I fq.691;
“Sherhul Esnevi” vëll. i I fq.281.
86. “Et-Telviyh alet-Tevdijh” vëll. i II fq.4;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.128;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.295;
“Mer’etil Usul” vëll. i II fq.211;
“Sherhul Mehalij” vëll. i II fq.119;
“Sherhul Esnevi” vëll. i II fq.210;

“Usulul Fikh li shejh Zekijud-Dijn Shaëban” fq.23;

“Muhaderat el Bena” fq.80.

87. Mutefikun alejhi, Ahmedi nga Ebi Hurejre në formulimin “Nëse në një enë pi ujë qeni, pastrone shtatë herë, ndërsa për të parën herë pastrone me dhe”.

Edhe pse ka transmetime të shumta në lidhje me këtë çështje, ky është më i sakti për shkak se e kanë transmetuar Buhariu dhe Muslimi.

Në transmetimin e Ebi Abijð el Kasim bin Selamit, në librin “Pastërtia” ekziston teksti “Nëse qeni pi në një enë tuajën, pastroni enën shtatë herë, të parën herë, apo në njërën herë prej herave le të jetë me dhe” (“Subule Selam” vëll. i I fq.22; “Nejlul Evtar” vëll. i I fq.26).

88. Mutefikun alejhi, po ashtu transmeton Ahmedi nga Ibn Amri (“Nejlul Evtar” vëll. i II fq.179, 182).

89. Mutefikun alejhi, po ashtu transmeton Ahmedi nga Ebi Hurejre r.a. (“Nejlul Evtarë” vëll. i V fq.214).

90. “Haraxh” është e hyrë profitable, blerësi pronëson mallin, ndërsa për kohën në disponim ia paguan shitësit vlerën e shfrytëzimit të atij malli.

Nëse njëri e blenë një parcel, ose një rob, ose një kafshë dhe e shfrytëzon, mirëpo më vonë e sheh ndonjë të metë (e cila nuk është cekur në kontratë). Blerësi ia kthen shitësit, por në të njëjtën kohë ia paguan vlerën e shfrytëzimit të atij malli, po aq kohë sa e ka mbajtur. Ky është (interpretimi) i hadithit të cilin e ka regjistruar Ahmedi, Ebi Davudi dhe Ibni Maxhe nga Aishja r.a. (“Nejlul Evtar” vëll. i V fq.212).

91. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.298;

“Ebu Hanife” autor Muhamed Ebu Zehra fq.280;

“El-Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq.201.

92. Transmetojnë një grup koleksionistësh të haditheve (Ahmedi dhe autorët e gjashtë koleksioneve) nga Ebi Hurejre r.a. (“Nejlul Evtar” vëll. i IV fq.206);

Vetëm Nesaiju nuk e ka transmetuar.

93. “Sherhul mehalij” vëll. i II fq.1999;

“El med’hal ila medhheb Ahmed” fq.43;

“Usulul Fikhi li Shaëban” fq.35.

94. E ka regjistruar Buhariu, Muslimi, Ahmedi dhe Maliku (në Muvetë) nga Hakim bin Hazani (“Nejlul Evtar” vëll. i V fq.184).

95. "Usulu Shashij" fq.85;
 "El Ihkam lil Amidi" vëll. i I fq.178;
 "El-Lema li Shijrazij" fq.39;
 "El-Ibhaxh" vëll. i II fq.204;
 "Sherhul Esnevi" vëll. i II fq.294, 310.

96. "Tëamul mukiijn" vëll. i I fq.30;
 "Revdatu Nadhir" vëll. i I fq.281;
 "El-med'hal ila medhheb Ahmd" fq.43.

97. "Sherhul mehalij" vëll. i II fq.148;
 "El Ibhaxh" vëll. i II fq.223;
 "Sherhul Esnevi" vëll. i II fq.224.

98. "El Ihkam li Ibni Hazm" vëll. i II fq.125;
 "Et-Telvijh alet-Tevdijh" vëll. i II fq.7;
 "Fevatihu Rahmut" vëll. i II fq.174;
 "Et-Tekrirë vet-Tehbirë" vëll. i II fq.188;
 "Irshadul Fuhul" fq.57.

99. "Et-Tevdijh sherh Tenkijh" vëll. i II fq.7;
 "Sherhul mehalij" vëll. i II fq.153;
 "Mer'etil Usul" vëll. i II fq.210;
 "Revdatu Nadhir" vëll. i I fq.323.

100. "Et-Tevdijh" fq.7;
 "Sherhul mehalij" fq.149;
 "Mer'etil Usul" fq.216;
 "Revdatu Nadhir" fq.324;
 "El Ihkam lil Amidi" vëll. i I fq.203;
 "Tëlamul mukiijn" vëll. i I fq.21;
 "Fevatihu Rahmut" vëll. i II fq.174;
 "Et-Tekrirë vet-Tehbirë" vëll. i II fq.288;
 "Sherhul Esnevi" vëll. i II fq.325.

101. "Irshadul Fuhul" fq.57.

102. "El-Ibhaxh" vëll. i II fq.223.

103. "El Ihkam lil Amidi" vëll. i I fq.203;
 "El-Lema li Shijrazij" fq.40;
 "Sherhul mehalij" vëll. i I fq.149;

“El Ibhaxh” vëll. i II fq.225;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.174.

104. Transmetojnë dy shejhat, Ahmedi dhe Tirmidhiu nga Ibni Mes’udi në formulimin “Gjenerata më e mira është gjenerata ime, pastaj gjenerata pas tyre, pastaj gjenerata pas tyre, pastaj do të vijnë gjeneratat ku dëshmia u kërkohet me përбетim, sepse përбетimi do të jetë dëshmi”.

105. “El mu’tëmid” vëll. i I fq.377;
“El Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq.89;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.302;
“Sherhul Udad” vëll. i II fq.22;
“Sherhul mehalij” vëll. i II fq.86;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.180;
“El Ibhaxh li Sebekij” vëll. i II fq.172;
“Sherhul Esnevij” vëll. i II fq.240;
“Gajetul Vusul” fq.92;
“Irshadul Fuhul” fq.31.

106. Transmeton Ahmedi dhe Buhariu nga Malik bin Huvejrithi (“Nejlul Evtar” vëll. i II fq.175).

108. “El Ibhaxh li Sebekij” vëll. i II fq.177.

109. “Sherhul Udadi” vëll. i II fq.23;
“El Ibhaxh” fq.17;
“Sherhul Esnevij” vëll. i II fq.240.

110. Transmetojnë gjashtë koleksionistët e haditheve dhe Ahmedi nga Omeri r.a. (“Nejlul Evtarë” vëll. i V fq.40).

111. “Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.181;
“Sherhul Esnevij” vëll. i II fq.241.

112. “Sherhul Udadi”;
“El Ibhaxh” fq.172.

113. “Fevatihu Rahmut”
“Hashijetu Nesmatul Es’har” fq.226;
“Mer’etil Usul” vëll. i II fq.144;
“Et-Tevdijh shehut-Tenkijh” vëll. i II fq.15.

114. “El-Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq.60;
“El-Ibhaxh” vëll. i II fq.172;
“Sherhul Esnevi” vëll. i II fq.241.
115. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i III fq.2;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.189.
116. “El-Muëtemid li-Ebil Husejn” vëll. i I fq.288;
“El-Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq.98;
“Sherhul udadi” vëll. i II fq.26;
“El-Ibhaxh” vëll. i II fq.177;
“Fevatihu Rahmut” vëll. i II fq.202;
“Sherhul Esnevi” vëll. i II fq.251;
“Irshadul Fuhul” fq.24.
117. “El mëtemid” vëll. i I fq.289;
“Risaletu fi Usuli Dhahirijeti li Ibni Arabi” fq.22;
“Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.3;
“Sherhul Mehalij” vëll. i II fq.295;
“El-Med’hal ila Medhheb Ahmed” fq.197.
118. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë” vëll. i II fq.3.
119. “El-mëtemid” vëll. i I fq.290;
“El-Ihkam lil Amidi” vëll. i I fq.98;
“Sherhul Mehalij” vëll. i II fq.88;
“Sherhul Udadi” vëll. i II fq.26;
“El-Ibhaxh” vëll. i II fq.178;
“Sherhul Esnevi” vëll. i II fq.252;
“Irshadul Fuhul” fq.24.

LIBRAT E PËRKTHYESIT (Dr. Musli Vërbanit):

1. “Besimi në Zotin”,
2. “Melaqet e Zotit”,
3. “Besimi në Librat e Zotit”,
4. “Pejgamberët e Zotit”,
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”,
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”,
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”,
8. “Fikhu i Namazit”,
9. “Fikhu i Zekatit”,
10. “Fikhu i Agjërimit”,
11. “Fikhu i Haxhit”,
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”,
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”,
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit”,
15. “Nata e dhëndërisë”,
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”,
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”,
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”,
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”,
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur'anit”,
21. “Texhvidi i muslimanit të vogël”,
22. “Morali i muslimanit të vogël”,
23. “Vasijeti”,
24. “Ixhtihadi”,
25. “Trashëgimia”,
26. “Usuli fikhu për fillestarë”,
27. “Lutjet e jetës nga Kur'ani fisnik”,
28. “Vakëfi”,
29. “Drita e jetës”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE:

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim);
2. “Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi);
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrezak Nufel);
4. “Për Kushtetutën Islame” (Dr. Muhamed Sejid Ahmed El- Musejer);
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi);
6. “Vlera e kohës” (nga autori Amër Halid);
7. “Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid);
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid);
9. “Pendimi” (nga autori Amër Halid);
10. “Pasojat e mëkateve” (nga autori Amër Halid);
11. “Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
12. “Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
13. “Shkurtimi i thonjve në dritën e sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir);
14. “101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë” (nga autori Muhamed Eminë Xhundi);
15. “Fetavatë e Shaëravijut”;
16. “Usuli fikhu islam I (Ligjet e sheriatit)” nga autori Vehbetu Zuhejli
17. “Fjalë të arta të më të mirit të njerëzimit, Muhamedit a.s.”;
18. “Usuli fikhu islam II (Përpilimi i ligjeve prej teksteve të sheriatit)” nga autori Vehbetu Zuhejli;
19. “Usuli fikhu islam IV (Ixmairi)” nga autori Vehbetu Zuhejli.

Përmbajtja:

PJESA E PARË	5
Argumentet e sheriatit për të cilat janë pajtuar dijetarët.....	5
Tema e parë	8
Kur’ani fisnik apo libri fisnik.....	8
Definicioni i Kur’anit.....	9
Leximet e vetmuara.....	14
Dispozita e kiraeteve të vetmuara.....	15
“Bismilahi” a është ajet Kur’anor?.....	16
Argumentimi i Kur’anit fisnik.....	19
Mrekullia e Kur’anit Fisnik.....	20
Format e mrekullisë së Kur’anit.....	22
1. Mrekullia e të shprehurit, kuptimit, gjithëpërfshirja e ligjeve dhe qëllimet e tij.....	23
2. Atë që e zbulon shkenca, është vërtetuar në Kur’an.....	24
3. Lajmërimi për të ardhmen, të cilën nuk e di askush, përpos të Diturit të së fshehtës.....	26
Fjalë impresionuese dhe alegori të fuqishme.....	26
Ligjet e Kur’anit.....	28
Treguesi i Kur’anit për ligje.....	31
Kur’ani sqarues.....	32
Disa rregulla të Usulit që kanë të bëjnë me Kur’anin.....	35
TEMA E DYTË	40
SUNETI	40
1. Definicioni i sunetit.....	42
Ndarja e sunetit në bazë të zinxhirit.....	44
<i>E para:</i> Suneti mutevatir.....	45
<i>E dyta:</i> Suneti meshhur.....	47
<i>E treta:</i> Suneti i vetmuar.....	48
3. Argumenti i sunetit.....	49
Argumentet e mohuesve të argumentit të sunetit.....	53
Vendi i sunetit në krahasim me Kur’anin.....	56
5. Medhhebet e sehabëve dhe dijetarëve rreth të vepruarit me hadithin e vetmuar dhe argumentimi me të.....	59
Hadithi mursel.....	69
Dispozitat e hadithit mursel.....	70
6. Veprat e Pejgamberit s.a.v.s.....	74
Kundërshtimi i fjalëve me veprat e Pejgamberit s.a.v.s.....	77
<i>E para:</i> Kundërshtimi në mes dy veprimeve.....	77
<i>E dyta:</i> Kundërshtimi në mes të dy fjalimeve.....	78
<i>E treta:</i> Kundërshtimi i fjalës me veprën.....	79
Fusnotat.....	82